



Kumbona e së Diellës

Lindja e Jezusit – Giotto di Bondone 1304 – 1306



Përshumëvjet Krishtlindjen!

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2021



EJA, ZOT! ËSHTË KËSHNDELLË!

*Eja Zoti im,
është dita e Këshndellës!
Mbushma jetën me Jetë!
Ji për mua Fjala,
askush veç Teje
nuk mund të ma mësojë,
fillin dhe sosjen e sendeve!
Ji dritë,
më ndihmo ta ndezi
zjarrin e shuar,
e mbushma jetën me dritë!*

R.SH. - Vatikan



*Në pritje të Ardhjes së Zotit
Eja Zoti im,
është dita e Këshndellës!
Mbushma jetën me Jetë!*

*Ji për mua Fjala,
askush veç Teje
nuk mund të ma mësojë,
fillin dhe sosjen e sendeve!*

*Ji dritë,
më ndihmo ta ndezi
zjarrin e shuar,
e mbushma jetën me dritë!*

*Ji dëshmitar,
zgjoi tingujt e këngës nga gjumi,
preki rrezet e diellit
që të më ngrohë e të më ndrijë.*

*Ji korp i gjallë,
ndale në ajër të keqen,
që varet si shpatë përmbi mua!
Ktheje kohën e humbur,
në kohë të begatë!
Ndriçomë, që të ndriçoj
ke e pret plot besim
të ndezur pishtarin tim.*

*Ji e vërteta,
m'i fal thesaret
e ruajtura nën hirin e moteve!
Kthema në buzë
këngën e pakënduar
e Fjalën e kulluar
nga çdo kuptim i dyshimtë!
Ti mos premto që kënga për Ty,
t'humbari melodinë.*

*Ji hir,
që Emri Yt të tingëllojë
në zemrën njerëzore
prej zgjimit – në zgjim!
Ëndrrat përlyer
nga djersa e gjaku
të shndërrohen në dashuri,
për Ty - e për çdo Njeri!*





Imzot Angelo Massafra OFM KRISHTLINDJA VEZULLIM	4
Papa Françesku DITA E PESTË BOTËRORE E TË VARFËRVE	6
Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë DUHET KTHYER SYTË DREJT MË TË VARFËRVE	10
Dom Dritan Ndoci DASHURIA E BËRË NJERI	11
Imzot Angelo Massafra OFM HOMELI - SINODI DIOQEZAN	13
Dom Gjovalni Simoni KISHA NË ECJE SINODALE	15
Imzot Angelo Massafra OFM HOMELI - ZOJA E SHKODRËS	19
Moter Marjeta Gjoka QENIA NJERZORE NË TËRËSINË E SAJ	20
Imzot Angelo Massafra OFM HOMELI - 5 VJETORI I LUMNIMIT TË MARTIRËVE	24
Ph.d. Oltsen Gripshi GJENDJA SHPIRTËRORE E REFUGJATEVE	26
Imzot Angelo Massafra OFM ATË GJON SHLLAKU DHE ATË ANTON HARAPI	28
Kryipeshkvia Shkodër-Pult DEKRET - FAMULLIA "ZOJA E SHKODRËS"	29
Redaksia KTHIMI I LIN DELIJËS NË SHKODËR	31
Motrat Stigmatine 30-VJETORI I MOTRAVE STIGMATINE	32
Imzot Angelo Massafra OFM HAPJA E VITIT AKADEMIK	34
Redaksia PËRUIROHET BUSTI I MONS. ZEF OROSHIT	35

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIV, nr. 11/12 (549 - 550) Nëntor - Dhjetor 2021

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Arqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



KRISHTLINDJA VEZULLIM I DRITËS ENGJËLLORE

Mesazhi i urimit të Imzot Angelo Massafra-s
për Krishtlindjen 2021 dhe Vitin e Ri 2022



Për festën e Krishtlindjes së këtij viti, do të doja të kërkoja leje që të hyj në shtëpinë e secilit prej jush tek e cila do të arrijë ky mesazh.

E bëj me delikatesën e dikujt që nuk dëshiron të prishë qetësinë familjare, edhe pse e di se ndërhyrja ime do të jetë gjithsesi shkak sikleti për dikënd. Të mësuar siç jemi me poezinë e Krishtlindjes, është e papërshtatshme që të mendojmë se ajo mund të prishet.

Ndoshta kështu qe edhe për ata përbujtës që nuk deshën t'i humbnin klientët për shkak të klithmave të një fëmije, që do të lindte pas pak minutash, nëse do t'i kishin pranuar në bujtinën e tyre Jozefin dhe Marinë. Kështu mund të ketë qenë edhe për ato kafshë të gjora që pushonin të qetë në stallë kur gjumi i tyre u prish prej hapjes së derës nga e cila hynë Jozefi dhe Maria shtatzënë. E, pse jo, kështu duhet të ketë qenë edhe për barinjtë e trembur nga vezullimi i dritës engjëjllore që lajmëronte lindjen e një fëmije. Dhe çfarë shqetësimi duhet të ketë qenë për Herodin, i cili u tmerrua nga humbja e mbretërisë së tij, për shkak të rrëzimit nga froni prej një foshnjeje të porsalindur!

Çdo Krishtlindje është e tillë edhe për secilin prej nesh kur mendojmë të festojmë, duke mos marrë parasysh arsyen pse festojmë. Aq e vërtetë është sa i quajmë “Festat e fundvitit”, sepse është e

papërshtatshme që të pranojmë se arsyeja pse zbukurojmë, ndriçojmë, japim dhe marrim dhurata është lindja e Jezu Krishtit.

Sigurisht, nëse ai do të kishte mbetur përgjithmonë fëmijë, do të ishim më të kënaqur dhe ngjarja, si e tillë, do të ishte më e mirëpritur: në fund të fundit, bëhemi më të butë kur mendojmë për lindjen e një krijese të re. Por ky Fëmijë jo: është ndryshe! Ta shikojmë në prehrin e nënës së tij është si ta shikojmë atë të zbritur nga kryqi dhe të dorëzuar në krahët e Zojës së Dhimbshme; ta shohim duke pushuar në grazhdin e një stalle në shkëmb është si ta shohim të vendosur në varrin e bërë në shkëmb.

Ky Fëmijë ka lindur për të vdekur, si të gjithë ne! Ai lindi për t'i dhënë bezdi të keqes që banon në zemrat e njerëzve dhe për të na dhënë lirinë neve, të burgosurve të së keqes. Ta shikosh këtë Fëmijë është e pakëndshme, sepse Ai është ajo Fjala që pret si një thikë me dy tehe për të shqyer dhe për të nxjerrë në shesh të vërtetën tonë.

Po, Jezusi është e gjithë kjo! Por është edhe Ai që ha e pi me mëkatarët, që fal prostitutat, që u hedh vaj e verë plagëve të udhëtarit fatkeq dhe pastaj e vë mbi supe për t'i dhënë një shtëpi. Ai është bariu i mirë që shkon në kërkim të deleve të humbura, që shëron vetëm se dikush beson te Ai. Është edhe Ai



që na zbulon fytyrën e vërtetë të Hyjit, krejt Mirësi dhe Mëshirë.

Dëshira ime, pra, si dhe arsyeja pse e lejoj veten të hyj në intimitetin e familjeve tuaja besimtare dhe jobesimtare, është që kjo Krishtlindje të jetohet me guximin e pranimit të arsyes së festës, që është lindja e Jezusit. Krishti, Biri i Hyjit, vetë Hyji, që merr natyrën tonë njerëzore për ta bërë atë të re, duke e rikthyer në pafajësinë e saj origjinale.

Nuk kemi frikë ta mirëpresim Krishtin! Edhe nëse ndërgjegjja jonë mund të dridhet përpara mesazhit të Tij, dijeni se Ai është aty gati për të falur dhe për të mirëpritur secilin prej nesh, duke na zbuluar edhe një herë fytyrën e mëshirshme të Hyjit. Prandaj, të mos lejojmë që këtë festë ta jetojmë edhe një herë si paganë: ta shfrytëzojmë këtë rast për ta lejuar Fëmijën e Betlehemit që të hyjë në shtëpitë tona, në jetën tonë, në marrëdhëniet tona njerëzore, në vendet tona të punës, të kulturës, të shkencës. Nuk mund të bëjë keq Ai që ka ardhur vetëm për të mirën tonë.

Ai është pasuri për familjet me shumë fëmijë, ngushëllim për çiftet që nuk mund t'i kenë, falje për ata që ia kanë mohuar një fëmijë të drejtën për të lindur.

Ai është garanci për një rritje të shëndetshme, në moshë, urti dhe hir përpara Hyjit dhe përpara njerëzve të të gjithë fëmijëve, adoleshentëve dhe rinjve.

Ai është mbrojtësi i të drejtave të punëtorëve dhe një model drejtësie për ata që mund t'u ofrojnë një punë atyre që nuk e kanë atë.

Ai është “Krijuesi i Urtë” që u dhuron çdo urti dhe çdo shkencë të gjithë atyre që janë të angazhuar

për ta bërë këtë botë më të mirë me kulturën, shkencën, artet.

Ai është “Mrekullibërësi i fuqishëm” që shëron shpirtin dhe ka fuqi të shërojë edhe trupat; mbështetje për të gjithë të sëmurët dhe të moshuarit.

Ai është “Këshilltari i admirueshëm” që gjen vendin e duhur në vendet ku ushtrohet pushteti legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv.

Ai është “Kryeprihti i amshuar”, udhërrëfyes i sigurt për të gjithë ata që ia kanë dhuruar jetën e tyre Hyjit dhe vëllezërve si gjallërues të bashkësive fetare.

Urimi im ju mbërritë të gjithëve ju: qoftë vërtet një Krishtlindje e shenjtë me mikpritjen e sinqertë dhe të guximshme të Jezu Krishtit në jetën tonë.

Bekimi i Fëmijës së Betlehemit zbritë me bollëk mbi ju të gjithë.

+ Massafra





MESAZHI I ATIT TË SHENJTË FRANÇESKU DITA E PESTË BOTËRORE E TË VARFËRVE

E Diela XXXIII e Kohës Gjatë Vitit

Vatikan, 14 nëntor 2021



“Skamnorët do t’i keni gjithmonë me vete” (Mk 14,7)

1. “Skamnorët do t’i keni gjithmonë me vete” (Mk 14,7). Jezusi i shpalli këto fjalë në kontekstin e një dreke në Betani, në shtëpinë e njëfarë Simoni, i njohur si “i gërbuluri”, pak ditë përpara Pashkëve. Siç tregon ungjilltari, hyri një grua me një enë alabastrit plot me parfum shumë të shtrenjtë dhe ia zbrazi Jezuzit mbi krye. Ai gjest shkaktoi shumë habi dhe nxiti dy interpretime të ndryshme.

I pari ishte hidhërimi nga ana e disa prej të pranishmëve, përfshi dishepujt, të cilët duke pasur parasysh vlerën e parfumit – rreth 300 denarë, sa rroga vjetore e një punëtori, menduan që do ishte më mirë të ishte shitur dhe shumën t’ia kishin dhënë skamnorëve. Sipas Ungjillit të Gjonit, Juda merr këtë qëndrim: “Pse nuk u shit ky parfum për treqind denarë e nuk u nda skamnorëve?” Shën Gjoni vazhdon duke thënë se Juda “foli kështu, jo pse ishte fort në kujdes për skamnorë, por pse ishte vjedhës e mbasi ai e mbante qesen, vidhte çka qitej brenda.” (Gjn12,5-6). Nuk ishte rastësi që kjo kritikë e ashpër dilte nga goja e tradhtarit: kjo dëshmon që ata të cilët nuk respektojnë skamnorët tradhtojnë mësimin e Krishtit dhe nuk mund të jenë dishepujt e tij. Këtu sjellim në kujtesë fjalët e forta të Origjenit: “Juda dukej sikur shqetësohej për skamnorët [...]. Nëse sot është ende ndonjë që mban kuletën e Kishës dhe flet në

favor të skamnorëve, por nga ana tjetër merr atë që hidhet në kuletë, atëherë pastë pjesën e vet bashkë me Judën” (Koment i ungjillit të Mateut, 11,9).

Interpretimin e dytë e ka dhënë Jezusi dhe na bën të vlerësojmë kuptimin e thellë të gjestit të gruas. Ai thotë, “Lëreni! Pse po e trazoni? Ajo kreu një vepër të mirë ndaj meje” (Mk 14,6). Jezusi e di që po i afrohet vdekja dhe në gjestin e saj shikon një paraprirje të lyerjes së trupit të tij të pajetë përpara se ta varrosnin. Kjo ishte përtej çdo gjëje që të pranishmit e tjerë mund të imagjinonin. Jezusi po u kujtonte atyre se ai është i pari i skamnorëve, më skamnori i skamnorëve, sepse ai i përfaqëson ata të gjithë. Dhe Biri i Zotit pranoi gjestin e gruas edhe në emër të skamnorëve, të vetmuarve, të padobishëmve dhe të diskriminuarve. Ajo, me ndjeshmërinë e një femre, tregon që është e vetmja që kupton gjendjen shpirtërore të Zotit. Ajo grua anonime, ndoshta për këtë e destinuar të përfaqësojë të gjitha ato gra që gjatë shekujve do të heshtin dhe do të vuajnë nga dhuna, dhe u bë kështu gruaja e parë ndër ato që patën fatin e pranisë së rëndësishme në momentin kulmor të jetës së Krishtit: kryqëzimi i tij, vdekja, varrosja dhe Ringjallja. Gratë, aq shpesh të diskriminuara dhe të përjashtuara nga pozitat me përgjegjësi, në faqet e Ungjijve janë protagoniste në historinë e zbulimit. Më pas Jezusi, me një shprehje elokuede e lidhë atë grua me misionin e madh të ungjillizimit: “Përnjëmend po ju



them: kudo që, në botën mbarë, do të predikohet Ungjilli, do të tregohet edhe çka bëri kjo, në përkujtimin e saj.” (Mk 14,9).

2. Kjo “empati” e fortë midis Jezusit dhe gruas dhe interpretimi i tij për lyerjen e saj përkundrejt pikëpamjes së skandalizuar të Judës dhe të tjerëve mund të na çojë drejt një mendimi të frytshëm për lidhjen e pandashme midis Jezusit, skamnorëve dhe shpalljes së Ungjillit.

Fytyra e Zotit që shfaqet tek Jezusi është ajo e një Ati të shqetësuar për skamnorët dhe që është pranë tyre. E gjithë vepra e Jezusit konfirmon që varfëria nuk është rezultat i fatit, por një shenjë konkrete e pranisë së tij mes nesh. Nuk e gjejmë kur dhe ku duam ne, por e shohim në jetën e skamnorëve, në vuajtjet dhe nevojat e tyre, në kushtet shpesh çnjerëzore ku detyrohen të jetojnë. Asnjëherë nuk lodhem së përsërituri që skamnorët janë ungjillizuesit e vërtetë, pasi ishin të parët që janë ungjillizuar dhe janë thirrur për të bashkëndarë lumturitë e Zotit dhe Mbretërinë e tij (krh. Mt 5,3).

Skamnorët na ungjillizojnë gjithmonë dhe kudo, sepse na mundësojnë të zbulojmë në mënyra të reja fytyrën e vërtetë të Atit. “Ata kanë shumë për të na mësuar. Përveç se marrin pjesë në *sensus fidei*, ata përmes vuajtjeve të tyre njohin Krishtin e vuajtur. Është e nevojshme ta lemë veten që të ungjillizohemi prej tyre. Ungjillizimi i ri është një ftesë për të njohur forcën shpëtuese të ekzistencës së tyre dhe t’i vendosim në qendër të rrugëtimit të Kishës. Ne jemi thirrur për të zbuluar Krishtin tek ato, për t’iu huazuar zërin tonë në çështjet e tyre, por dhe për të qenë miqtë e tyre, për t’i dëgjuar, për t’i kuptuar dhe për të mirëpritur mençurinë misterioze që Zoti do të na komunikojë përmes tyre. Angazhimi ynë nuk qëndron vetëm tek aktivitetet apo programet e promovimit dhe ndihmës; ajo që vë në lëvizje Shpirti i Shenjtë nuk është një aktivizim i padisiplinuar, por mbi të gjitha një vëmendje për ta konsideruar tjetrin një me veten tonë. Kjo vëmendje dashurie është fillimi i një shqetësimi të vërtetë për personin e tyre dhe nisur nga kjo dua të kërkoj vërtetë të mirën e tyre” (Gëzimi i Ungjillit, 198-199).

3. Jezusi jo vetëm qëndron në krah të skamnorëve, por dhe ndan të njëjtin fat me ta. Ky është një mësim i fuqishëm edhe për dishepujt e tij të të gjithë kohërave. Kuptimi i Fjalëve të tij “Skamnorët do t’i keni gjithmonë me vete” është edhe ky: prania e tyre mes nesh është e përhershme, por nuk duhet të shkojë deri aty sa të na bëjë indiferentë, por të na përfshijë në një bashkëndarje të jetës që nuk pranon zëvendësime. Skamnorët nuk janë persona “jashtë” komunitetit, por janë vëllezër e motra me të cilët duhet të ndajmë vuajtjet, për të lehtësuar vështirësitë dhe marginalizimin e tyre, për t’i kthyer dinjitetin e humbur dhe për të garantuar përfshirjen e tyre të nevojshme sociale. Nga ana tjetër, siç e dimë, veprat e bamirësisë presupozojnë dhuruesin dhe marrësin, ndërsa nga bashkëndarja lind vëllazëria. Lëmosha është rastësore; ndërsa bashkëndarja është e qëndrueshme. E para rrezikon të kënaqë atë që e jep

lëmoshën dhe të poshtërojë atë që e merr; e dyta forcon solidaritetin dhe hedh themelet e nevojshme për të pasur drejtësi. Me pak fjalë, besimtarët, kur duan të shohin Jezusin dhe ta prekin me duart e tyre, e dinë ku të drejtohen: skamnorët janë sakramenti i Krishtit; ata përfaqësojnë personin e Tij dhe drejtohen tek ai.

Janë të shumtë shembujt e shenjtërve të cilët bashkëndarjen me të varfërit e kanë bërë projektin e jetës së tyre. Mendoj, ndër të tjerë, për At Damiano de Veuster, apostullin e shenjtë të të gërbulurve. Ai, me shumë bujari, iu përgjigj thirrjes për të shkuar në ishullin Molokai, i cili ishte bërë një geto ku kishin qasje vetëm të gërbulurit, për të jetuar dhe vdekur me ta. Përveshi mëngët dhe bëri çdo gjë që mundi për të përmirësuar jetën e atyre që ishin të varfër, të sëmurë dhe të dëbuar. Ai u bë mjek dhe infermier, i shkujdesur ndaj rreziqeve që i kanoseshin, dhe i dha dritën e dashurisë asaj “kolonie të vdekjes”, siç u quajt më pas ishulli. Ai vetë u sëmur nga gërbula, që u bë shenjë e një bashkëndarje totale të fatit të vëllezërve dhe motrave për të cilët kishte dhënë jetën. Dëshmia e tij është shumë aktuale në ditët e sotme, të shënuara nga pandemia e koronavirusit. Hiri i Zotit sigurisht vepron në zemrat e të gjithë atyre që, pa u shfaqur, konsumojnë veten për më të varfrit, duke bashkëndarë konkretisht gjithçka me to.

4. Ndaj, kemi nevojë të ndjekim me gjithë zemër ftesën e Zotit: “Kthehuni e besoni Ungjillit!” (Mk 1,15). Ky shndërrim së pari qëndron në hapjen e zemrës tonë për të njohur format e shumta e të ndryshme të skamjes dhe në shfaqjen e Mbretërisë së Zotit përmes një stili jetese në përputhje me besimin që ushtrojmë. Shpesh, të varfrit shikohen si persona të veçantë, si një “kategori” që ka nevojë për shërbime specifike bamirësie. Sidoqoftë, ndjekja e Jezusit sjell ndryshim mentaliteti, që përfshin sfidën e bashkëndarjes dhe të përfshirjes. Të bëhesh dishepull i tij do të thotë të vendosësh për të mos grumbulluar pasuri në tokë, që japin iluzionin e një sigurie që realisht është e brishtë dhe e shkurtër. Kjo kërkon vullnet për t’u çliruar nga çdo gjë që na pengon të arrijmë lumturinë dhe harenë e vërtetë, për të njohur atë që zgjat dhe që nuk mund të shkatërrohet nga asgjë dhe askush. (krh. Mt 6,19-20).

Edhe në këtë rast mësimi i Jezusit shkon kundër rrymës, sepse premton atë çfarë vetëm sytë e besimit mund të shohin dhe përjetojnë me siguri të plotë: “Kushdo që të lërë, për dashuri të emrit tim, shtëpi ose vëllezër, ose motra, ose babë ose nënë, ose grua ose fëmijë, ose ara, do të marrë njëqind për një dhe do të fitojë jetën e pasosur” (Mt 19,29). Nëse nuk vendosim të bëhemi të varfër duke hequr dorë nga pasuritë, pushteti material dhe kotësia, kurrë nuk do mundemi të japim jetën për dashuri; do të jetojmë një jetë të copëtuar, të mbushur me qëllime të mira, por të paafte për të ndryshuar botën. Ndaj, kemi nevojë të hapemi ndaj hirit të Krishtit, gjë që mund të na bëjë dëshmitarë të bamirësisë së tij të pa kufi dhe t’i kthejë besimin praninë tonë në botë.

5. Ungjilli i Krishtit na fton t’i kushtojmë një



vëmendje të veçantë skamnorëve dhe të njohim format e ndryshme e të shumta të çrregullimit moral e social që gjithnjë prodhojnë forma të reja të skamjes. Duket se po shtohet mendimi që skamnorët jo vetëm që janë përgjegjës për gjendjen e tyre, por dhe që përbëjnë një barrë të patolerueshme për një sistem ekonomik të përqendruar tek interesat e disa grupeve të privileguara. Një treg që injoron apo zgjedh mes parimeve etike, krijon kushte çnjerëzore për ata që tashmë ndodhen në situata të pasigurta. Po shohim krijimin e kurtheve të reja të varfërisë dhe përjashtimit, të krijuara nga aktorë ekonomikë e financiarë të paskrupullt, të cilëve u mungon ndjenja e humanizmit dhe përgjegjësisë sociale.

nga papunësia, që prek në mënyrë dramatike burrat kryefamiljarë, gratë dhe të rinjtë. Solidariteti social dhe bujaria, që falë Zotit shumë njerëz kanë treguar, po japin, bashkë me projekte larg-pamëse të promovimit njerëzor, një kontribut shumë të rëndësishëm në këto rrethana.

6. Megjithatë, mbetet një pyetje që nuk është aspak e qartë. Si mund t'i japim një përgjigje të prekshme atyre miliona varfërve, të cilët shpesh përballen vetëm me indiferencë, për të mos thënë me fyerje? Cila rrugë e drejtësisë duhet ndjekur për të kapërcyer pabarazitë sociale dhe për të rikthyer dinjitetin njerëzor, kaq shpesh të nëpërkëmbur? Mënyrat individualiste të jetesës janë bashkëfajtores në shkaktimin e skamjes, dhe



Sidoqoftë, vitin e kaluar përjetuam një fatkeqësi tjetër që shumëfishoi numrin e skamnorëve: pandeminë. Ajo vazhdon të trokasë në dyert e miliona njerëzve, dhe, edhe kur nuk sjell vuajtje e vdekje, mbart me vete skamje. Të varfërit janë shtuar në mënyrë të përpjesëtuar dhe fatkeqësisht do të vazhdojnë të shtohen në muajt e ardhshëm. Disa vende po vuajnë pasojat shumë të rënda të pandemisë, ndaj pjesa më e brishtë e popullsisë së tyre vuajnë mungesën e gjërave të domosdoshme. Radhët e gjata përpara mensave për të varfërit janë një shenjë e prekshme e këtij përkeqësimi. Ekziston nevoja e qartë për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për të luftuar virusin në nivel global, duke mos promovuar interesat e palëve. Është veçanërisht urgjente ti jepen përgjigje konkrete atyre që janë goditur

shpesh ia shkarkojnë skamnorëve përgjegjësinë për gjendjen e tyre. Por skamja nuk është rezultat i fatit, është pasojë e egoizmit. Prandaj është vendimtare ti japim jetë *proceseve zhvillimore*, ku të vlerësohen aftësitë e të gjithëve, në mënyrë që plotësimi i aftësive dhe diversiteti i roleve të çojnë drejt një burimi të përbashkët pjesëmarrjeje të përbashkët. Mes “të pasurve” ekzistojnë shumë forma të skamjes që mund të zbuten nga kamja e “skamnorëve”, nëse ata mund të takohen dhe të njohin njëri tjetrin! Askush nuk është aq i varfër sa të mos mund të japë diçka nga vetja në shkëmbim të ndërsjellë. Skamnorë nuk mund të jenë vetëm ata që marrin; ata duhen vendosur në pozitë për të dhënë, sepse e dinë mirë si të përgjigjen me bujari. Sa shembuj bashkëndarjeje kemi para syve tanë! Shpesh



skamnorët na mësojnë për solidaritetin dhe bashkëndarjen. Është e vërtetë se ka njerëz të cilëve u mungojnë disa gjëra, përfshi dhe thjesht ato të domosdoshmet, e megjithatë atyre nuk u mungon çdo gjë, sepse ata ruajnë *dinjtëtin e bijve të Hyjit*, që asgjë e askush nuk mund t'ua heqë.

7. Për këtë arsye kërkohet një *qasje ndryshe* ndaj skamjes. Kjo është një sfidë që duhet ta nisnin Qeveritë dhe institucionet botërore me një model social largpamës, i aftë për të luftuar format e reja të skamjes që po pushtojnë botën dhe që sigurisht do të prekin dhe dekadat e ardhshme. Nëse skamnorët izoloohen, sikur ato ta kishin fajin për gjendjen e tyre, atëherë vetë koncepti i demokracisë do të rrezikohej dhe të gjitha politikat sociale do të falimentonin. Me shumë përlulësi duhet ta pranojmë që shpesh jemi të paafte, kur bëhet fjalë për skamnorët. Flasin për ta në abstraksion; ndalemi në statistika dhe mendojmë se mund të prekim zemrat e njerëzve duke xhiruar një dokumentar. Përkundrazi, skamja duhet të na motivojë për planifikim krijues, që synon të shtojë lirinë që duhet për të jetuar një jetë përmbushjeje, sipas aftësive të secilit. Është një iluzion, të cilin duhet ta refuzojmë, të mendosh që liria vjen dhe rritet nga posedimi i parasë. Ti shërbesh skamnorëve me efektivitet na vë në lëvizje dhe bën të mundur gjetjen e mënyrave më të përshtatshme për zhvillimin dhe promovimin e kësaj pjese të njerëzimit, që shumë shpesh është anonime dhe pa zë, por që ka të stampuar fytyrën e Shpëtimtarit që kërkon ndihmën tonë.

8. “Skamnorët do ti keni gjithmonë me vete” (*Mk* 14,7). Është një ftesë për të mos e humbur kurrë mundësinë që të ofrohet për të bërë mirë. Në sfond, mund të zbatojmë urdhrin e lashtë biblik: “Nëse një nga vëllezërit apo motrat tua ... është në nevojë, mos e ngurtëso zemrën dhe mos e tkurr dorën ndaj nevojës së tyre. Përkundrazi, zgjatu dorën dhe me bujari jepu mjaftueshëm për të plotësuar nevojën e tyre... Kur u jep, jepu me bujari dhe mos e trishto zemrën. Në fakt, pikërisht për këtë, Ati, Zoti yt, do të të bekojë në çdo punë e çdo gjë ku do kesh vënë dorën. Sepse nevojtarët nuk do mungojnë kurrë në tokë” (*Lp* 15,7-8.10-11). Me një frymë të ngjashme, Apostulli Pal nxiti të krishterët e bashkësive të tij të vepronin në të njëjtën mënyrë “pa mërzi apo detyrim, sepse Zoti e do atë që dhuron me gëzim” (*2Kor* 9,7). Nuk bëhet fjalë për të qetësuar ndërgjegjen tonë duke dhënë lëmoshë, por për të kundërshtuar kulturën e indiferencës dhe padrejtësisë që kemi krijuar përkundrejt skamnorëve.

Në këtë kontekst bëjmë mirë të kujtojmë fjalët e Shën Gjon Krizostomit: “Ata që janë bujarë nuk duhet të kërkojnë llogari për sjelljen e skamnorëve, por vetëm të përmirësojnë gjendjen e tyre të skamjes dhe të plotësojnë nevojën e tyre. Skamnorët kanë vetëm një mbrojtje: skamjen e tyre dhe gjendjen e nevojës në të cilën ndodhen. Mos u kërko asgjë tjetër; por edhe në qofshin njerëzit më të egjër në botë, nëse u mungon ushqimi i domosdoshëm, le t'i çlirojmë nga uria... Mëshirëplotët janë si një port për ata në nevojë:

porti pret dhe çliron nga rreziku të gjithë ata që u është mbytur anija; qofshin keqbërës, njerëz të mirë, apo çfarëdo qofshin, porti i strehon në gjirin e vet. Prandaj, edhe ju, kur shikoni në tokë një burrë apo një grua që ka vuajtur përmbytjen e varfërisë, mos i gjykoni, mos u kërkon llogari për sjelljen e tyre, por çlirojnë nga fatkeqësia e tyre”. (Nga Fjalimet mbi Lazrin skamnor, II, 5).

9. Është vendimtare që ne të rrisim ndjeshmërinë për të kuptuar nevojat e skamnorëve, të cilat ndryshojnë vazhdimisht, si dhe kushtet e tyre të jetesës. Në fakt, sot, në zonat më të zhvilluara ekonomike njerëzit janë më pak të gatshëm se në të shkuarën për tu përballur me skamjen. Gjendja e mirëqenies relative, me të cilën jemi mësuar, e bën më të vështirë të pranojmë sakrificat dhe humbjen. Njerëzit janë të gatshëm të bëjnë çdo gjë për të mos humbur frytet e fitimit të kollajtë. Si rezultat kalojnë në forma fyerjeje, nervozizmi spazmatik dhe kërkesa që çojnë në frikë, ankth dhe, në disa raste, në dhunë. Nuk është ky kriteri mbi të cilin të ndërtojmë të ardhmen tonë; vetë ato sjellje janë forma të skamjes të cilat nuk mund t'i shpërfillim. Ne duhet të jemi të hapur e të lexojmë shenjat e kohërave që na kërkojnë të gjejmë mënyra të reja për të qenë ungjillizues në botën bashkëkohore. Ndiurma e menjëhershme për t'iu përgjigjur nevojave të skamnorëve nuk duhet të na pengojë për të qenë largpamës për zbatimin e shenjave të reja të dashurisë dhe bamirësisë së krishterë, si përgjigje ndaj formave të reja të skamjes që përjeton sot njerëzimi.

Unë uroj që *Dita Botërore e të Varfërve*, që tashmë përkujtohet për të pestin vit, të mund të rritet gjithnjë e më shumë në Kishat tona vendore dhe të frymëzojë një lëvizje ungjillizimi që t'i takojë skamnorët personalisht, kudo që ata të jenë. Ne nuk mund të presim që skamnorët të trokasnin në derën tonë; ne në mënyrë urgjente duhet ti arrijmë në shtëpitë e tyre, në spitale dhe shtëpi përkujdesi, në rrugë dhe në qoshtet e errëta ku ndonjëherë fshihen, në strehëza dhe qendra pritjeje. Është e rëndësishme të kuptojmë se si ndihen, çfarë po përjetojnë dhe çfarë dëshiron zemra e tyre. Le t'i bëjmë tonat lutjet e përzemërta të At Primo Mazzolarit: “Ju lutem të mos më pyesni nëse ka të varfër, kush janë ato dhe sa janë, sepse kam frikë që ato pyetje përbëjnë një tërheqje të vëmendjes apo një pretekst për të shmangur një thirrje të qartë për ndërgjegjet dhe zemrat tona... nuk i kam numëruar kurrë skamnorët, sepse nuk mund të numërohen: skamnorët duhen përqaftuar, jo të numërohen” (“*Adesso*” n.7-15 prill 1949). Skamnorët janë mes nesh. Sa ungjillorë do të ishte po të mund ta thoshim me gjithë vërtetësi: edhe ne jemi skamnorë, sepse vetëm kështu do të mundemi vërtetësi të njohim ata, ti bëjmë pjesë të jetës tonë dhe një mjet të shpëtimit tonë.

*Romë, Shën Gjoni në Lateran, 13 qershor 2021,
Përkujtimi i Shën Antonit të Padovës*



DUHET KTHYER SYTË DREJT MË TË VARFËRVE

MESAZH

Me rastin e *Ditës së Pestë Botërore për të Varfrit*, që kremtohet të dielën me 14 Nëntor 2021, me temë “*Të varfrit i keni gjithmonë me ju*” (Mk14.7) ne, Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri, shprehim shqetësimin tonë, duke vënë re ndikimet shumë negative të krizës ekonomike botërore e cila ndërthuret edhe me veçantitë e situatës kritike që ka përfshirë vendin tonë prej kohësh.

Si barinj të Kishës i kemi ndjekur ndryshimet fiskale të ndodhura në kohët e fundit, sikurse rritja e çmimeve të produkteve të shportës, karburanteve dhe gazit (si dhe është përfolur edhe për rritjen e çmimit të energjisë elektrike) dhe vërejmë me keqardhje mungesën e vëmendjes që duhet për të varfrit e nevojtarët, për të pamundurit e të mënjanuarit e shoqërisë sonë.

Ky mesazh është një ftesë dhe njëkohësisht një nxitje për të marrë masa konkrete e për t'i kthyer sytë drejt më të varfërve, sepse Zoti kur zbuloi fytyrën e vet e shfaqti atë si Atë për të varfrit dhe pranë të varfërve e po ashtu detyra e një shoqërie është t'u vijë në ndihmë më të brishtëve në mesin e saj.

Të qenit qeveritar, vendimmarrës, politikëbërës nuk është vetëm një pozitë që reflekton autoritet, por është një thirrje për të shërbyer, për t'iu dhënë zë kauzave që u mungon zëri, për të qenë miqtë e nevojtarëve, për të dëgjuar britmat e të varfërve në mjerimet e tyre.

Le ta kenë të varfrit e nevojtarët në mesin tuaj, si vendimmarrës, zërin e tyre të mbështetur e të fuqizuar e nëse ua fuqizojmë këtë zë, të mos t'i lëmë ta humbasin shpresën, sidomos kur ajo lidhet me mirëqenien e dinjitetin e jetesës. “Kjo vëmendje dashurie është fillimi i një shqetësimi të vërtetë për qenien e tyre dhe duke filluar nga kjo, fillon edhe kërkimi i të mirës për ta” (EG 198-199).

Tërmeti, pandemia, kriza e përshkallëzuar ekonomike, që ndihet tek rritja e çmimeve të prodhimit e kanë shtuar numrin e parregullsisë morale e shoqërore që sigurisht shkaktojnë gjithnjë e më shumë forma të reja varfërie, si pasojë e aktorëve ekonomikë e financiarë të paskrupullt, të privuar nga çdo ndjeshmëri njerëzore e përgjegjësi shoqërore.

Radhët që shtohen e bëhen më të gjata në qendrat tona për të varfrit, kërkesa e vazhdueshme, sidomos e familjeve të reja dhe e të rinjve, për emigrim, janë shenjë e prekshme e përkeqësimit të ekonomisë dhe mundësive për nevojtarët, duke treguar rritjen e numrit të tyre.

“Varfëria nuk shkaktohet prej fatit, por

është pasojë e egoizmit”. “Kështu, të varfrit na mësojnë solidaritetin, bashkëndarjen, sepse mishërojnë dinjitetin e dhënë nga Zoti që askush nuk mund t'ua marrë” – na thotë Papa Françesku në mesazhin e tij për Ditën botërore të të varfërve.

Prandaj, ky mesazh është një thirrje e fortë për ata të cilëve populli iu ka besuar administrimin e të mirës së përbashkët, për politikën, për qeverinë, që të mos e humbasin mundësinë për ta bërë të mirën, sepse “Zoti i do ata që dhurojnë me gëzim” (2 Kor 9,7).

Ky mesazh i drejtohet Qeverisë, Kuvendit të Shqipërisë, Institucioneve financiare vendase dhe ndërkombëtare, Bashkive të vendit, që të mbështesin dinjitetin e të varfërve dhe nevojtarëve.

Kështu, le t'i kundërvihemi të gjithë së bashku kulturës së indiferencës, padrejtësisë dhe përjashtimit. Viktimat e para të kësaj kulture janë pikërisht të varfrit, nevojtarët e të mënjanuarit.

Me bindjen se do të dëgjohet zëri i të varfërve, sikurse na fton edhe Papa Françesku, ne Ipeshkvijtë përtërijmë angazhimin tonë për të qenë pranë nevojtarëve, ashtu sikurse kemi bërë gjithmonë, duke ofruar mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë dhe të institucioneve tona të bamirësisë, në këtë sfidë kundër varfërisë, brenda mundësive tona, por me gjithë vetveten tonë.

Gjithashtu sigurojmë lutjen tonë për të mirën e përbashkët, paqen dhe shpresën në vendin tonë! Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët!

Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri





Dom Dritan Ndoci

DASHURIA E BËRË NJERI !

Festa e Krishtlindjes që po afron, na ndihmon edhe një herë të hyjmë më thellë në misterin e pamasë të Mishërimit të Zotit tonë. Thuhet në jetën e Shën Françeskut të Asizit se kishte ndodhur një herë që, gjatë ngrënies, ishte përhumur aq shumë saqë e kishte ndërprerë të ngrënët. Bashkëvëllëzërit e tij, duke e shkundur pak, e pyetën: «Atë Françesk, çfarë ndodhi?». E ai: «Jo asgjë. Po mendoja vetëm se si ka mundësi që Zoti është bërë njeri». E jo rastësisht ishte pikërisht ky Shenjt që “shpiku” i pari punimin e Betlehemit, që sot gjendet në çdo kishë.

Mbase nuk është nevoja të përhumemi edhe ne gjatë ngrënies, por patjetër mund ta lejojmë veten të mbështillemi nga ngrohtësia e misterit të Mishërimit të Birit të Hyjit.

Duke qenë se Hyji-Trini është Dashuri, atëherë kjo do të thotë se Biri, duke u bërë njeri, ka bërë të mundur që vetë Dashuria të bëhet njeri në personin e tij.

Fatkeqësisht ne njerëzit (e këtu nuk dua ta përjashtoj as veten time) jemi shumë të aftë të shndërrohemi në *lypsarë*. Edhe atëherë kur nuk kemi nevojë. Lypsarët që shohim rrugëve, jo të gjithë janë në atë gjendje ngaqë vërtet nuk e patën bekimin të kenë një jetë ndryshe, por ngaqë vetë *zgjodhën* – e vazhdojnë *të zgjedhin* – ta sigurojnë bukën e përditshme në atë mënyrë. Por, në një nivel shumë të fshehtë shpirtëror, të gjithë ne, tepër shpesh madje, shndërrohemi, si pa e vënë re, në lypsarë: lypim pak pushtet, lypim pak autoritet, lypim pak mirënjohje e,

më e shpeshta, lypim pak dashuri. Tjetër gjë është të mirëpresësh e ta shijosh mirënjohjen, përzëmërsinë e dashurinë e të tjerëve kur të dhurohen e tjetër gjë është të shndërrohesh në lypsar të tyre. Të shndërrohemi në lypsarë nënkupton t’ia lejojmë vetes të tjetërsohemi, të heqim dorë nga gjërat që edhe ne vetë e dimë mirë se janë me vlerë e me kuptim. E përse? Sepse egon tonë tashmë e kemi lejuar të sëmuret.

E prandaj shpesh ne rendim pas pak dashurie, pas pak vëmendjeje, pas pak pushteti. Prandaj shpesh lejojmë të mashtrohemi, edhe atëherë kur e nuhasim se jemi duke u mashtuar. Shpesh ia lejojmë vetes të jemi mashtues, edhe atëherë kur vazhdon të na vrasë ndërgjegja. Shumë shpesh ndokush vetëm për pak pushtet shitet. Shumë veta, vetëm e vetëm me qëllim që të dëgjojnë dy fjalë të ngrohta e të përzemërta dashuriçkash, lëshohen në aventura afektive të rrezikshme. E edhe vetë e dinë shumë mirë se sa të rrezikshme dhe se sa të pafryte janë, por nuk janë në gjendje ta marrin në dorë jetën e tyre, sepse vazhdojnë të zgjedhin të mbeten lypsarë. Vazhdojnë të enden me dorën e shtrirë e të thonë: «Më jepni 100 lekë dashuri».

Ndonjë shembull bashkëkohor të këtij lloji lypsarësh? Ata që fiksohen pas “pëlqimeve” në facebook, instagram a ku e di unë, duke hedhur çdo ditë – e shpesh edhe tri apo katër herë në ditë – statuse ose foto absolutisht të pa kuptimta. Nën maskën e një intelegjence apo lumturie fallso,





shpesh fshehin vetëm identitetin prej lypsari që kanë filluar të zgjedhin në jetë. Por kjo është e mjerueshme.

Kemi dëshirë të dukemi të pëlqyeshëm, të mençur, të pazëvendësueshëm, jo ngaqë duam t'i dhurojmë diçka botës që na rrethon, por ngaqë duam të mbledhim sadopak mirënjohje, duartrokitje, adhurim. Shumë saktë e ka thënë Blejz Paskal qysh në shek. XVII: «*Jemi kaq mendjemëdhenj, sa do të donim që të na njihte mbarë bota dhe jemi kaq mendjelehtë, saqë vlerësimi i pesë apo e gjashtë personave rreth nesh na gëzon e na kënaq*». Shumë pak kush e di se Paskali ishte një i krishterë i bindur. Prandaj ndoshta arrinte ta shihte më mirë mendjelehtësinë që shpesh ne njerëzit ia lejojmë vetes.

Krishtlindja nuk na e lejon të harrojmë se Dashuria, *vetë Dashuria*, është bërë Njeri dhe se e ka emrin JEZUS, se ka jetuar në këtë botë, se ka folur me njerëzit.

Të hysh në komunikim me Jezusin në jetën tënde, do të thotë të shkosh direkt tek burimi i dashurisë e jo të shkosh ta kërkojsh ujin nëpër kanale. Burimi garanton pastërtinë, kanalet shumë shpesh jo. Prandaj hape Ungjillin e do të kuptosh çfarë ka thënë e çfarë ka bërë Jezusi.

Është e vërtetë se, të kërkojsh dashuri, mirënjohje e përzemërsi, nuk ka ndonjë gjë të keqe, por kujdes sepse mund të rendim pas dashurive që na shndërrojnë në skllevër. Ndërsa dashuria e pastër, e matur dhe e painters, të bën të lirë. Disa thonë se dashuria e vërtetë është si e verbër. Këto janë përralla. A i keni vënë re se sa vigjilentë janë

prindërit ndaj nesh, duke u kujdesur për ne deri në detajet më të imta? Po të ishte e verbër ajo dashuri, nuk do t'i vërenin këto detaje. Nuk ndalen tek gabimet tona jo nga marrëzia, por nga largpamësia që kanë. Dashuria e vërtetë të bën shumë vigjilent e shumë largpamës.

Hape Ungjillin, lutu (mundësisht të kesh ndonjë çast sado të shkurtër lutjeje çdo ditë), mos e lër pas dore meshën e së dielës, mos e lër pas dore sakramentin e rrëfimit. Gjej kohë herë pas here edhe për vetmi. Të rrish vetëm me Jezusin. Kështu do të kapesh fort pas *Burimit të Dashurisë*.

Ki kurajon të mësosh nga dashuria e Jezusit, fillo edhe ti të duash vërtet, pa interes, si Zotin ashtu edhe njerëzit. Ki kurajon të falësh ata që të fyejnë. Ki kurajon të shfaqësh mirësi ndaj njerëzve. Gjej mënyrën të qortosh, por pa fyer e pa poshtëruar. Bëhu i fortë e filloja sërish këtyre gjëra kur të lodhesh apo kur ta kesh vënë re se përsëri je shndërruar në lypsar. Në lidhje me mëkatet e tua, beso se Jezusi të do e të fal po ia kërkojsh këtë sinjerisht. Mëso t'i kesh përzemër veprat e mira, gjërat me vlerë.

Kështu Krishtlindja nuk do të kalojë pa fryte edhe për ty. Kështu ti vetë do të jesh i frytshëm. Atëherë do ta vësh re se sa keq ishte gjendja e mëparshme prej lypsari të dashurisë. Ke për ta parë se lypsarët e përjetshëm të dashurisë kanë për ta lakmuar shëndetin tënd shpirtëror e, ndoshta, në fshehtësinë e zemrës së tyre do të përpiqen edhe ata të shërohen.

A e shikon se sa shumë të mira ka sjellë në botë Jezusi, Dashuria e bërë Njeri?



HOMELI
ME RASTIN E HAPJES SË SINODIT DIOQEZAN
17/10/2021 - Imzot Angelo Massafra OFM – Arqipeshkev



Sot hapim ecjen sinodale edhe në Kishën tonë dioqezane, në bashkim me të gjitha Kishat e tjera të botës dhe në vazhdimësi me hapjen zyrtare që u bë në Romë të dielën e kaluar. Një ngjarje hiri për të cilën thërrasim me forcë dhe përlësi praninë e Shpirtit Shenjt për ta udhëhequr dhe për ta orientuar ecjen e Kishës universale në kohën tonë, që të gjithë po me forcë dhe përlësi e përjetojmë si një kohë krizash dhe ndryshimesh të mëdha epokale.

Të vetëdijshëm se çdo moment krize mund të jetë edhe një mundësi e madhe për ndryshime pozitive, edhe ne, Kisha e Shkodër-Pultit, duam të japim kontributin tonë në këtë ecje, duke u angazhuar seriozisht për të bashkëpunuar me pjesëmarrjen tonë, me sugjerimet tona, me leximet tona të realitetit, pa u ndalur që të qajmë për plagët tona, por duke rimarrë ecjen me guxim drejt një rilindjeje të vërtetë.

Modeli që duhet të kemi gjithmonë para syve tanë duhet të jetë ai i Marisë, ashtu siç që në të gjitha momentet kur, pas tragjedisë së komunizmit, njerëzit tanë bartën, në çdo ngjarje feje, ikonën e Zojës së Këshillit të Mirë që tani e shohim të ekspozuar në altarin e kishës sonë Katedrale. Ajo që dëshmitare e vdekjes së Birit të saj në Kryq, por edhe dëshmitare e Ngjalljes së tij, së bashku me Apostujt.

Më pëlqen ta imagjinoj këtë Sinod dhe punën sinodale që po ndërmarrim me imazhin që na paraqitet Ungjilli i sotëm, ai i Jezusit i cili me durim dhe dashuri mbledh apostujt e tij për t'i edukuar ata në shërbim dhe përlësi, duke e paraqitur veten e vet si model si në aktin e pirjes së kupës së hidhur të

Mundimeve, ashtu edhe të të zhyturit në Pagëzimin e Vdekjes dhe Ngjalljes së tij.

Në fund të fundit, të jesh Kishë do të thotë të ndihesh i mbledhur nga Krishti si nxënës të Tij të dashur dhe bij të Mundimeve, të Vdekjes dhe të Ngjalljes së tij. Të jesh nxënës do të thotë të jesh plotësisht dakort me mendimin e Mësuesit, por edhe me shembullin e tij të jetës. Ne jemi Kishë dhe nxënës vetëm kur kuptojmë të vërtetën rreth Jezusit dhe misionit të tij; vetëm kur reshtim së imagjinuari atë si një Hyj që përmbush dëshirat tona dhe fillojmë t'i vëmë në jetë mësimet e tij dhe të ndjekim shembullin e tij.

Fatkeqësisht, nuk është gjithmonë kështu! Shpesh, si i riu i pasur në Ungjillin e së dielës së kaluar, mendojmë se mund të jemi nxënës të Krishtit vetëm falë respektimit të jashtëm të urdhërimeve, por pa u liruar nga idetë, pozicionet, bindjet dhe vetja jonë, domethënë pa hyrë në një marrëdhënie të thellë me Mësuesin.

Shpesh, si apostujt e Ungjillit të sotëm, e imagjinojmë veten si ndjekës të një personi të fuqishëm që mund t'i përmbushë dëshirat dhe qëllimet tona, dhe jo si ndjekës të një të kryqëzuarit që u bë shërbëtor i të gjithëve nga dashuria e tij për t'i treguar botës se deri në ç'pikë mund të arrijë dashuria e Atit për njerëzimin.

Prandaj është e rëndësishme që ta fillojmë këtë Sinod para së gjithash me vetëdijen se jemi nxënës të mbledhur nga Mësuesi, të gatshëm për ta vënë në praktikë mësimin e tij dhe të vendosur për ta ndjekur shembullin e tij.



PER SINODIN:

**Bashkim,
Pjesëmarrje- bashkëpërgjegjësia
dhe Mision**

Pika kryesore e Sinodit është ecja së bashku, duke përfshirë të gjithë besimtarët e Kishës, nën udhëheqjen e Shpirtit Shenjt, që do të lusim çdo ditë.

Shumë e rëndësishme është të nënvizojmë tre elemente kyçe të këtij Sinodi: Bashkim, Pjesëmarrje- bashkëpërgjegjësia dhe Mision.

***Bashkimin:** “Jemi të përhapur në krejt Dioqezën, por Zoti na bashkon në një”; “Qëllimi s'është ai për të qenë të gjithë njësoj, por për të ecur së bashku, duke bashkëndarë një ecje të përbashkët dhe duke përqaftuar larminë tonë”; “Bashkimi që Zoti ndërton në mes nesh është më i fortë se çdo ndarje”; “Në mes të dallimeve tona të shumta, jemi të bashkuar në pagëzimin tonë të përbashkët, si gjymtyrë të Trupit të Krishtit

***Pjesëmarrjen- bashkëpërgjegjësia:** edhe besimtarët laikë duhet të kenë një rol. Duhet edhe të bëhet një përpjekje për të përfshirë ata që ndonjëherë janë të përjashtuar, personat që përjetojnë varfërinë dhe braktisjen, personat që jetojnë me një handicap, të rinjtë, gratë, etj.

***Misionin,** mund të theksohen dhuratat dhe karizmat (dhuntitë) e shumta të popullit të Hyjit në dioqezë dhe duke ritheksuar konceptet kyçe sikurse vijnë më poshtë: “Çdo i krishterë ka një rol jetik për të kryer në misionin e Kishës”; “Të gjithë të

pagëzuarit dhe të krezmuarit janë gur të gjallë në ndërtimin e Trupit të Krishtit”; “Askush s'është i përjashtuar nga gëzimi i Ungjillit”; “Laikët kanë një mision të veçantë në dëshmimin e Ungjillit në të gjitha fushat e shoqërisë njerëzore”; “Sikurse dishepujt e Jezusit, jemi tharm në mes të njerëzimit deri kur mbretëria e Hyjit të lindë në mbarë botën”.

Vellezer dhe motra, do të shpërndalet një pyetësore: secili le ta marrë dhe të përgjigjet, duke pasur famullinë si pika riferimi.

Karakteristika tjetër e këtij sinodi tregohet të leximi i dytë: besimi. Pikërisht për shkak të "dobësisë" të cilës Jezusi iu nënshtrua, pavarësisht se ishte Hyj, jemi të sigurt se marrim hir dhe mëshirë. Dhe, gjithnjë të vetëdijshëm se ajo që i përket Mësuesit u përket edhe nxënësve, angazhohemi që të jemi si ai, të aftë për mëshirë mes nesh dhe me mbarë njerëzimin. Analizat që do të na duhet të bëjmë gjatë Sinodit, në fakt, mund të na bëjnë të biem në grackën e gjykimit pa mëshirë, të dënimit pa apel; mund të na çojnë në zemërim dhe dhunë. Por duhet të jemi si Jezusi, të lirë nga e gjithë kjo dhe gati për mëshirë.

Po e përfundoj me rreshtin e fundit të Psalmit përgjigjes, si një lutje dhe dëshirë për ecjen tonë sinodale: “Shpirti ynë pret Zotin; ai është ndihma jonë dhe mburoja jonë. Mirësia jote qoftë mbi ne, o Zot, sepse kemi pasur shpresë te ti” (Ps 33, 20.22).

Zoja Maria, Nëna Terezë e Të lume Martire tanë na ndihmofshin në këtë ecje.



Dom Gjovalni Simoni
Shkodër

KISHA NË ECJE SINODALE PËRGJATË KOHËS SË ARDHJES *“Shpirti Shenjt dhe Nusja thonë: Eja!” (Maranà tha!) (Zb 22,17)*

Kjo Kohë e Ardhjes në këtë vit, e gjënë Kishën universale dhe atë lokale në një ecje sinodale, dhe në një përkim të plotë me qëllimet e përbashkëta drejt rrugëtimit me Zotin nën frymëzimin e Shpirtit Shenjt. Papa Françesku që në fillimin e dokumentit përgatitor për ecjen sinodale lëshon një pyetje reflektuese mbarë Kishës: “si ta realizojmë sot, në nivele të ndryshme (nga ato lokale-vendore, tek ajo universale atë “ecje-rrugëtim së bashku”, e cila i mundëson Kishës të shpallë Ungjillin në përputhje me misionin që i është besuar dhe cilët janë hapat që Shpirti na fton të kryejmë në mënyrë që të rritemi si Kishë sinodale”? Duket qartë që në fillim se Papa ia beson këtë ecje frymëzimit të Shpirtit Shenjt: “që të përballojmë së bashku këto pikëpyetje, nevojitet që të vihem në dëgjimin e Shpirtit Shenjt, i cili është si era: ‘fryn në drejtimin që do; ja dëgjon ushtimën e nuk e di nga vjen e ka shkon’ (Gjn 3, 8).

Prandaj kam menduar që në përputhje me këtë bashkë-ecje sinodale, të ndalem e të reflektoj mbi temën “*Shpirti Shenjt dhe Nusja thonë: Eja*”, sepse jam i bindur se mbanë në vetvete përmasën pneumatologjike si dhe ekleziale e nxitur kjo nga dëshira tipike e Kohës së Ardhjes për të pritur Dhëndrin, Krishtin Zot. Mos të harrojmë se nuk jemi ne protagonistët e ndryshimit të ecjes kishtare, e as të ecjes sonë. Është Shpirti i Zotit që i flet Kishës e na flet neve. Është thelbësore atëherë që të vihem nën dëgjimin e Shpirtit (*ab-audire*-pra të vendosesh poshtë Atij që po flet me një qëndrim dëgjues dhe përvujtëruës; i hapur me krejt qenien tënde ndaj dëgjimit të Fjalës së Zotit). E gjithë kjo temë dëshiron të shtrihet ose të endet bukur në ecjen sinodale të propozuar tashmë nën udhëzimin e tre fjalëve kyçe: bashkim-pjesëmarrje-mision.

Bashkimi

Bashkimi është sekreti i një jete të qëndrueshme me Zotin qoftë si Kishë, si familje dhe si jetë personale. *Bashkimi (koinonia) lind nga feja e cila buron nga predikimi apostolik, ushqehet nga thyerja e bukës dhe nga lutja dhe shprehet në dashurinë vëllazërore e në shërbim.* “Vëllezërit ishin vazhdimisht të kujdesshëm për ta përvetësuar mësimin e apostujve dhe nuk mungonin në mbledhjet vëllazërore, në ndarjen e bukës e në uratë” (Vap 2,42). Nëse duam të bëjmë një kujtim të gjallë të fillimit të Kishës, është mirë që në këtë kohë të rimarrim librin e veprave të Apostujve, sepse aty kemi një para-pasqyrim të jetës së Kishës. Sigurisht që Kisha sot është strukturuar në një mënyrë më të përparuar por nuk duhet ta humb frymëzimit fillestarë që e ka burimin në Shpirtin Shenjt.

Shën Ireneu e përshkruante kështu fillimin e Kishës: “*aty ku është Kisha, është edhe Shpirti i Zotit; e*



aty ku është Shpirti i Zotit, aty është edhe Kisha me çdo hir, sepse Shpirti është e vërteta”. (Adversus haereses, III, 24, 1: PG 7,966). Pra ekziston një lidhje e ngushtë mes Shpirtit Shenjt dhe Kishës. Shpirti Shenjt e ndërton Kishën dhe i dhuron asaj të vërtetën dhe zbrazë në zemrat e besimtarëve dashurinë (krh Rm 5,5).

Një përmasë shumë e rëndësishme e lidhur me temën që kemi marr nga Libri i Zbulesës është pikërisht dimensionin martesor që del në pah në figurën e Nuses që është Kisha. Ajo në këtë Kohë Ardhjeje me afshin e zemrës thërret me mall dashurie bashkimin me Dhëndrin, Krishtin Jezus: *Maranà tha- Eja o Zot Jezus!* Ky dimension martesor, na ndihmon ne meshtarëve që në figurën e Krishtin jemi pjesë e të qenit Dhëndër, por nga ana tjetër jemi edhe pjesë e Kishës- Nuse. Nga ana tjetër ky dimension ndihmon edhe të martuarit që ta jetojnë lidhjen martesore me këtë shpirt dashurie të pamasë që ekziston mes Krishtit dhe Kishës. (krh. Ef 5,21-33). Sa shumë mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin duke jetuar mirë thirrjen tonë, si meshtarë, të shuguruar ose të martuar!



© Antoine Mekary | ALETEIA

Kjo lidhje e ngushtë mes Shpirtit të Zotit dhe Kishës (Nuses) nuk e asgjëson natyrën tonë njerëzore bashkë me dobësitë e saja. Kështu, bashkësia e parë e krishterëve njohu që në fillim gëzimet e Shpirtit të Zotit në zemrat e besimtarëve, por nga ana tjetër u ndeshen edhe me kundërshtime të ndryshme si rezultat i pranimi të së vërtetës. Këto kundërshti i sollën jo pak probleme bashkësisë së parë të krishterë, duke sjell përçarje të ndryshme. Pra mund të themi se sikur që në fillim ekzistonte dashuria në mes të bashkësisë, (krh. *1Gjn 1,1*) ashtu u fut edhe ndarja e përçarja në mesin e saj. Pra, është gjithmonë rreziku që në ngjarjet e botës dhe në dobësitë e Kishës të humbet feja, e kështu të rrezikohet edhe dashuria vëllazërore. Shën Pali nga ana tjetër na nxit kështu: “*Vëllezër, mos e trishtoni Shpirtin Shenjt të Hyjit, me të cilin Hyji ju vulosi për ditën e shpërblimit. Le të flaket larg jush çdo pikëllim, zemërim, hidhërim, britmë, shamje me çdo lloj ligësie. Përkundrazi, jini njëri për tjetrin të mirë, zemërdhimbshëm; falni njëri-tjetrin sikurse edhe Hyji ju falin në Krishtin*” (Ef4, 30)

Shën Gjoni në letrën e tij të parë e shpreh shumë qartë këtë tension që ishte që në fillim në bashkësinë e krishterë, duke nxitur kështu më shumë dashurinë vëllazërore. Por nga na tjetër ai është shumë i ashpër edhe me armiqët, ata të cilët i shkaktojnë Kishës ndarje e përçarje. Kisha e dashurisë dhe e bashkimit, është edhe Kisha e së vërtetës, që nënkupton më së shumti besnikërinë ndaj Ungjillit të besuar nga Jezu Krishti. Vëllazëria e krishterë lind nga të qenit bij të njëjtut Atë

nga Shpirti i së vërtetës. “Sepse bijtë e Hyjit janë ata, të cilët i udhëheq Shpirti i Hyjit” (Rm 8,14). Por familja e bijve të Hyjit ka nevojë për rojtaret të cilët kujdesen për bashkimin, dashurinë e paqen mes vëllezërve të bashkësisë. Kjo është thirrja e shërbesës Apostolike, ku nën frymëzimin e Shpirtit të Shenjt, pasardhësit e Apostujve, Ipeshkvijtë janë ata që përpiqen të mbjellin këtë paqe e bashkim brenda bashkësisë së Krishterë. Nga ana tjetër nuk është vetëm punë e tyre, secili anëtar duhet të ndihmojë Ipeshkvin, për të ruajtur harmoni e bashkimin, si shenjë e pranisë së Zotit në mesin tonë.

Me siguri që Bashkimi nuk është krejt vepër e jona, është mbi të gjitha vepër e Zotit nëse ne i hapemi Atij. Papa Benedikti XVI thoshte: “*ne mund të arrijmë me të vërtetë në cakun e bashkimit të plotë, vetëm nëse e lëmë Zotin të veprojë. Njësimi i dukshëm i gjithë të krishterëve, është përherë vepër, që vjen nga lart, nga Zoti. Është vepër, që kërkon përvujtëri, kërkon njohjen e ligështive tona e pranimin e dhuratës së Zotit. Por, nëse përdorim një shprehje, që e përsëriste shpesh Shën Gjon Pali II, çdo dhuratë bëhet vetvetiu edhe impenjim. Prandaj duhet kujtuar se njësimi, që vjen nga Zoti, kërkon edhe impenjimin tonë të përditshëm, kërkon t'ia hapim zemrat njëri-tjetrit, me dashuri të krishterë*”.

Të gjithë ne atëherë, të vulosur nga Shpirti Shenjtë, shpirti i bashkimit, madje edhe të shuguruar disa prej nesh dhe të frymëzuar nga ai, jemi në të njëjtën kohë edhe pjesë e Kishës, e nuses, që në këtë kohë më së shumti thërret ardhjen e Dhëndrit- Eja o Zot Jezus! Është koha, tani që të ndalemi e ta pyesim vetën: a jam



unë element bashkues në Kishë? A mbjelli bashkim apo përçarje? A jam lajmëtar i së vërtetës apo jam shprallës, dhe mbjellës i thashethemeve? Sa i jam në krah Ipeshkvit në këtë mision bashkimi? Sa i gjendem në krah vëllait ose motrës në vështirësi? Mendoj se në këtë kohë ardhjeje dhe ecje sinodale është një rast i mirë edhe për një shqyrtim ndërgjegjeje të mirë. Jezusi dëshiron që në këtë Kohë Ardhjeje të gjejë të bashkuar, ai vjen të sjellë bashkimin e trefishtë: në ne, mes nesh dhe me Zotin. Le të bëhemi ura bashkimi në këtë Kohë Ardhjeje.

Pjesëmarrja

Misteri i Kohës së Ardhjes është i lidhur shumë me domethënien e fjalës “pjesëmarrje”, sepse Biri i Zotit, dëshiron të marrë pjesë në jetën tonë, jo vetëm të na shikojë nga lart poshtë por të ecën përkrah nesh, madje të marrë natyrën tonë njerëzore (krh. *Fil* 2,1-11). Është Ai që na mëson artin e pjesëmarrjes, të përfshirjes, të dashurisë, që i përvjel mangët e duarve që shërbejnë e bëhen pis. Kjo është pjesëmarrja; i ngjan emaptisë, bëhet pjesëmarrës i gëzimeve dhe i vuajtjeve të tjetrit, madje deri në vdekje. Jezusi ka ardhur jo vetëm të “marrë- pjesë”, por, të *marrë përsipër*, mbi supet e veta mëkatet tona e t'i shlyej mbi drurin e kryqit në Kalvar.

Duke e parë në këndvështrimin historik dhe ekleziologjik por në situatën tonë pas komunizmit në Shqipëri, pjesëmarrja, tingëllon pak çuditshëm në veshët e besimtarëve tanë, të cilët nuk e kanë jetuar si duhet frymën e Konkilit II të Vatikanit. Akoma ekziston një farë hezitimi, stepje dhe pasiviteti përballë angazhimeve të Kishës, duke arsyetuar me shprehjet si: “është punë e meshtarit kjo”! “Ipeshkvi i din ma mirë këto gjëra”! “Nuk na duhet gjë me u përzier me punët e Kishës!” etj. Kjo ka sjellë një farë dembelizmit shpirtërorë dhe një farë ndarje mes besimtarëve dhe meshtarëve e motrave. Kam lexuar një artikull të bukur që fliste për famullinë duke e krahasuar me një shtëpi që po ndërtohej: Meshtari, është si mjeshtri, janë edhe disa njerëz që janë si ata punëtorët që i afrojnë materialet, por ka edhe shume të tjerë që vetëm kalojnë, shikojnë, dikush përshëndet, dikush nuk interesohet fare e dikush vetëm është kurioz të dijë kot ndonjë lajm.

Papa Françesku në frymën e Konkilit II, dëshiron që të na nxisë edhe ma shumë që të ndihemi pjesëmarrës. Kemi nevojë atëherë, të ndalemi e të mendojmë që nën frymëzimin e Jezusit që është zhytur në mesin e botës, por edhe nga nxitja e Papës dhe e Konkilit, të ndryshojmë pak shikimin tonë ndaj Kishës. Sa bukur do të ishte sikur të gjithë të kemi të njëjtin zell për të mirën e Kishës, dioqezës, famullisë! Mos të harrojmë, Kisha është Nëna e jonë, e secili i ka diçka borxh Nënës së vet, në kuptimin e mirënjohjes së dashurisë. Ajo na ka lindur në fe, në të kemi hedhur hapat e parë, nga ajo ushqehemi me Korpin e Krishtit dhe në të gjejmë shërimin e mëkateve tona të shumta.

Edhe pse jemi të ndryshëm, si thirrje por edhe si

misjon që bëjmë në Kishë, të gjithëve na bashkon Shpirti Shenjt. Fakti që jemi të ndryshëm i përngjajmë mozaikut; ku, secili shkëlqen në copëzën e vet, por kur bashkohet me bashkësinë, jep një rrezatim edhe me të madh, i shfaqim botës fytyrën e Krishtit. Më pëlqen që t'ju paraqes një pjesë të Shkrimit të Shenjt që e kam fort për zemrën kur bëhet fjalë për shërbimet e ndryshme në Kishë. Është pikërisht letra e Shën Palit apostull drejtuar Korintianëve (*IKor* 12). Në këtë pjesë Shën Pali e krahason Kishën me gjymtyrët e Trupit të Krishtit. Secila gjymtyrë -thotë Shën Pali ka rolin e vet. Edhe një dhimbe e një gjymtyrë krejt të vogël, ndalon rritnin e krejt trupit dhe si pasojë, të gjitha gjymtyrët kujdesën për të. Sa i bukur është ky krahasim, edhe për ne besimtarët që jemi “pjesëmarrës” në jetën e Kishës! Secili është i çmuar në sytë e Zotit, pavarësisht nga shërbimi që bën. Pa të, do të ishte i mangët trupi i Krishtit. Ky shembull na bën që të jemi edhe të përvuajt, sepse, secili vlen njësoj në Trupin e Krishtit, prandaj nuk ka privilegje, siç na frymëzon logjika e botës për lavdinë e rreme. Nga ana tjetër del në pah edhe kujdesi që duhet të kemi për gjymtyrët më të dobëta, sepse në anatominë e trupit gjithçka ka vendin e vet.

Shpesh herë nga frika për t'u takuar me dobësitë tona shmangim edhe takimin e me dobësitë e të tjerëve. Prandaj me të drejtë Kardinal J.H. Newman thoshte: “*Shpesh herë nuk i prekim deri në rrënjë plagët e natyrës sonë njerëzore. Në vend që t'i hedhim themelet e fesë sonë në brendësinë tonë, pastrojmë vetëm pjesën e jashtme. Jemi të mirësjellshëm dhe shoqërorë me njëri-tjetrin, me fjalë e me vepra, por dashuria mes nesh nuk rritet. Kemi frikë të bashkëndajmë thellësitë tona shpirtërore dhe si pasojë, feja jonë duke u parë vetëm si një sistem shoqërorë, mbetet bosh. Në të nuk shihet prania e Krishtit*”

Ajo që e bën Kishën dhe pjesëtarët e saj të besueshëm është kur në to shkëlqen fytyra e Zotit me dashurinë dhe mëshirën e Tij të pakufi. Kjo arrihet nëse ne të parët e lejojmë vetën të ndriçohemi nga kjo dritë me anë të lutjes dhe takimit tonë personal me Jezusin. Në këtë kohë të ardhjes e pyes vetën: a e lejoj që ardhja e Zotit tonë, të më bëjë më pjesëmarrës në Kishë? A jam i gatshëm t'i ndyjë duart në veprat e shërbimit e të bamirësisë? A jam si Simon Cireneu, që i shti shpatullat e mia Kishës, duke ndihmuar Ipeshkvin, meshtarët e ata që kanë nevojë për të mirën e Kishës?

Më pëlqen që në fjalën pjesëmarrje të ketë vend edhe për dy fjalë tjera: bashkëpërgjegjësi dhe shërbim. Sepse kur merr pjesë në diçka, në një farë mënyre jam edhe përgjegjës, dhe kur merr pjesë me përgjegjësi e dashuri, ky është edhe shërbim. E shërbimi, është forma më e lartë e artit të dashurisë që Krishti na ka lënë në darkën e fundit (krh. *Gjn* 13,1-20). Kjo bëhet edhe më nxitëse për ne nëse e mendojmë shërbimin si një identifikim me personin e Krishtit. Kështu, na mëson një lutje e vjetër: “*Krishti nuk ka duar, ka vetëm duart*



tona për të bërë punën e tij sot. Krishti nuk ka këmbë, ka vetëm këmbët tona për t'i drejtuar njerëzit tek Ai. Krishti nuk ka gojë, ka vetëm gojën tonë për t'u folur njerëzve të sotëm. Ne jemi e vetmja Bibël, që të gjithë popujt e lexojnë akoma sot. Ne jemi thirrja e fundit e Hyjit e shkruar në fjalë e në vepra”

Misioni

Vetë Ardha e Jezusit në tokë është një ardhje misionare. Prandaj Koha e Ardhes është energjia shpirtërore që na shtynë edhe neve të dalim nga vetja, nën logjikën e Krishtit fëmijë të shkojmë tek më të varfrit e të varfërve. Çfarë është misioni? Është rrezatimi i bashkimit dhe i dashurisë. Kjo vlen edhe për Trininë Shenjte, sepse ardhja e Jezusit në tokë, është pikërisht rrezatimi i njësisë trinitare dhe gjithashtu edhe i dashurisë së tyre për ta përfshirë edhe njeriun e botën në gjirin trinitarë. Nga ky shpirt misionar i Trinës së Shenjt, buron mund të themi edhe misioni i Kishës. Ja çfarë thotë edhe Kushtetuta dogmatike “Lumen Gentium” nr.17: *“Ashtu si në të vërtetë Biri është dërguar prej Atit, po kështu edhe ai vetë i ka dërguar apostujt (krh. Gjn 20,21) duke u thënë: “Shkoni e bëni nxënës të mi të gjithë popujt! Pagëzoni në Emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt! Mësoni të zbatojnë gjithçka që ju kam urdhëruar! Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë-deri në të sosur të botës!” (Mt 28,18-20). Dhe këtë urdhër solemn të Krishtit për të shpallur të vërtetën shpëtimtare, Kisha e ka marrë prej apostujve për ta vazhduar plotësimin e tij deri në fund të kufijve të tokës (krh. Vap 1,8). Pra, ajo i bën të vetat fjalët e apostullit: “ i mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!” (1Kor 9,16). Dhe vazhdon ti dërgojë lajmëtarët e Ungjillit, derisa kishat e reja të jenë krejtësisht të themeluara dhe ta vazhdojnë veprën e ungjillëzimit”.*

Misioni fillon nga vetvetja, ose më mirë, fillon kur ti vendos të dalësh nga vetvetja e t'i shkosh në takim tjetrit. Të jesh solidarë me atë që nuk e ka pasur akoma mundësinë ta njohë Lajmin e Mirë, Jezu Krishtin. Pastaj, misionari i parë je ti kur në familjen tënde vendos të jesh i hapur edhe për të tjerët jo vetëm për veten. Pastaj vjen famullia, pastaj dioqeza, e ndoshta kur të piques mirë në fe, mund të marrësh guximin edhe të kapërcesh detin ose oqeanin e ta shpallësh ungjillin edhe jashtë vendit tënd. Por të jesh misionar nuk do të thotë të bësh një *religious tours*, pra si një turist religjioz. Misioni është çështje feje. Nuk mund të jesh misionarë i Krishtit nëse përpara nuk e ke bërë përvojën e takimit personal me Krishtin. Prandaj, edhe pjekuria e të krishterit është arritja e një përshpirtërie mistike e takimit me Zotin, ashtu siç e kanë arritur shenjtërit. Karl Rahner thoshte: “I krishteri duhet të jetë një mistik, pra një që ka bërë përvojën e takimit personal me Krishtin, ose në të kundërt nuk është i krishterë”. Disa kanë bërë më mijëra kilometra udhëtime siç është p.sh. Shën Pali, disa të tjera kanë qenë misionarë edhe pa asnjë kilometër, por me një misticizëm të thellë shpirtërorë, siç është p.sh. Shën Tereza e Jezusit fëmijë.

Një shenjtëreshë vetëm 24 vjeçare, e cila nuk ka bërë ndonjë udhëtim të jashtëm, por ama ka bërë një udhëtim shumë të thellë të brendshëm të takimit personal me Krishtin. Jo më kot, Kisha pastaj e quan pajtorja e misioneve, sepse brenda vetës, e ndiente shtysën e dashurisë së Krishtit, për t'ua çuar dashurisë e tij gjithkujt. Ajo na thotë që më shembullin e jetës së saj, në ekonominë e Hirit të Zotit, e për shëlbimin e njerëzimit, lutja dhe vuajtja vlejnë njësoj si të dhurosh jetën në terrenet e vështira misionare për të çuar Lajmin e Mirë të Krishtit Shëlbues. Një të diel, duke shikuar Krishtin e kryqëzuar, lejoi që zemra e saj të shporohej nga një rreze e dashurisë së tij që e shtynte të jepte gjithçka për të tjerët, për shëlbimin e shpirtave. Por, sekreti i gjithë kësaj është dashuria. Prandaj, Shën Tereza e Jezusit fëmijë, në autobiografinë e saj, pas shumë përpjekjesh shpirtërore tregon në rrëfimet e saja se thirrja kryesore e jetës është të jesh dashuria në zemrën e Kishës. *“Kuptova më në fund se dashuria përqafton dhe përfshinë çdo thirrje; që dashuria është gjithçka, që shtrihet në çdo kohë e në çdo vend. Me një fjalë: dashuria është e përjetshme. Vetëm atëherë, e ngashënjyer nga gëzimi magjepsës kllitha fort: O Jezus, dashuria ime! E gjeta thirrjen e jetës sime. Thirrja ime është dashuria. E gjeta vendin tim në Kishë, këtë vend, që ma ke dhuruar Ti o Zoti im. Në zemrën e Kishës, nënës sime, unë do të jem dashuria; dhe do të përpigem me gjithë zemër që ta bëj realitet”.*

Nuk ka mision pa këtë takim personal me Krishtin, nuk ka mision pa bërë përvojën e kësaj dashurie që të nxjerr nga egoizmi yt e të dhuron falas për të tjerët. E gjitha kjo ndodhë në Kishën tonë, kjo Nuse e Krishtit që me afsh të zemrës në këtë kohë e thërret Dhëndrin e vet: Eja o Zot, Jezus! Mund të themi se forca më efikase e shpalljes së Ungjillit (misionit) qëndron në fjalët e Jezusit në Ungjillin e Gjonit: “nëse do ta duani njëri tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënësit e mi”. Duke dashur njëri tjetrin dëshmojmë se duam edhe vetë Jezusin dhe njëkohësisht duam edhe Kishën. Dashuria për Zotin dhe për të tjerët (dmth. dëshmia konkrete e jetës), është mënyra më efikase e shpalljes së Ungjillit (misionit). Le ta duam Kishën dhe si thotë shprehja latine *sentire cum ecclesiae*, të ndiejmë bashkë me Kishën. Jezusi Fëmijë po vjen sepse dëshiron që ne pjesëtarë të Korpit mistik të Tij, dhe anëtarë të Kishës- Nuses së Tij, të jemi më të dashuruar me Të.

Ardhja jote, o Zot Jezus, na e ndez të zemrën me dashuri për Ty e për Kishën edhe atëherë, kur logjika e botës na shkurajon dhe na e errëson fytyrën tënde. Por Ti, je Ylli që zhdavaritë çdo mjegullinë dhe lind si Dielli i drejtësisë për t'i dhënë botës paqe e dashuri.

Virgjëra Mari, Nëna e Kishës dhe Nëna pritjes, Zoja e papërlyer na ndihmoftë që të jemi gjymtyrë të denja të Trupit të Krishtit dhe që të jetojmë gjithmonë të lidhur me Të si shermendi me hardhinë, në mënyrë që të japim shumë fryt dhe fryti ynë të jetë i qëndrueshëm.



HOMELI ME RASTIN E FESTËS SË ZOJËS SË SHKODRËS 18/10/2021 - Imzot Angelo Massafra OFM – Arqipeshkev

Ashtu si në predikimin e djeshëm, me rastin e hapjes së Ecjes sinodale në Arqipeshkvinë tonë, edhe sot, në këtë festë që qyteti i Shkodrës kremton Pajtoreshen e vet, vazhdoj t'ju paraqes Atë që duhet të jetë referimi i qenies sonë si Kishë dhe si nxënës të Jezusit.

Zoja e Shkodrës, ose Nëna e Këshillit të Mirë, siç u quajt më vonë në Gjenacano, është ikona e identitetit të popullit tonë, fytyra në të cilën të gjithë ne e njohim veten... ajo fytyrë e dashur dhe e përkëdhelur nga Biri. Fytyra e Marisë është fytyra jonë: në atë fytyrë edhe ne jemi të dashur dhe të përkëdhelur nga Jezu Krishti.

Ta shikojmë me vëmendje këtë ikonë e cila, e restauruar dhe e kthyer në shkëlqimin e saj pas restaurimeve të bëra disa vite më parë, tani spikat në këtë altar dhe i fton të gjithë të meditojnë për atë që ajo shpreh. Ta lëmë veten të tërhiqemi nga ngjyra e arit të aureolave dhe të skajeve të veshjeve dhe në to të shohim shkëlqimin dhe dritën e amshimit që ato përfaqësojnë dhe drejt të cilit të gjithë duhet të priremi. Amshimi duhet të përcaktojë fundin ose kufirin e gjithçkaje në jetën tonë: aktivitetet tona, dëshirat dhe aspiratat tona, angazhimet e përditshme të gjendjes sonë të jetës (rregulltare, të martuar, fëmijë, studentë, punëtorë, etj.): gjithçka duhet të priret drejt Amshimit.

Të lëmë veten të ndriçohemi nga shkëlqimi i atyre fytyrave të bardha dhe të ndritshme që simbolizojnë hyjninë. Sigurisht që vetëm Biri është hyjnor, por Maria është Nëna e Hyjit; edhe Jezusi në Ungjill, duke cituar shkrimet, thotë: *“A nuk shkruan në Ligjin tuaj: Unë thashë: Hyjë jeni?”* (Gjn 10,34): Ai, duke marrë pjesë në njerëzimin tonë, na bëri edhe ne pjesëtarë të hyjnisë së tij. Sa e bukur është kjo perspektivë e shenjtërisë, e cila na përket neve si një thirrje përfundimtare!

Të mahnitemi nga veshja e kuqe, e dhunshme dhe e përgjaktë e rrobave të Birit, shenjë e njerëzimit me të cilën u vesh për ne, për të na siguruar shpëtimin përmes Mundimeve, Vdekjes dhe Ngjalljes së tij dhe ta falënderojmë me gjithë zemër për dhurimin e vetvetes për shpëtimin e botës.

Ashtu siç duhet të mahnitemi përpara ngjyrës blu të mantelit të Virgjërës, e cila na kujton Parajsën dhe na tregon se si, pavarësisht se jemi krijesa, fati ynë ndërthuret në mënyrë të pashmangshme me vetë jetën e Hyjit, bij të të cilit jemi. Me Shën Palin mund të përsërisim: *“E nëse jemi fëmijë - atëherë jemi edhe trashëgimtarë, trashëgimtarë të Hyjit e bashkëtrashëgimtarë me Krishtin, sikurse në të vërtetë vuajmë bashkë me Të, që edhe të lavdërohem bashkë me Të”* (Rom 8,17).

Ta lëmë veten të ngushëllohem nga ngjyra e gjelbër



e veshjes së Marisë që na kujton shpresën, një virtyt që nuk duhet të mungojë kurrë në jetën e të krishterit. Deri në atë pikë sa Papa Françesku na e përsërit shpesh: *“Mos lejoni që t'ju vjedhin shpresën!”*. Maria na e tregon rrugën e shpresës, ajo që mbeti e fortë në këmbët e kryqit dhe që priti me durim kumtimin e Ngjalljes në Çenakull. Kështu edhe ne, në situatat tona të jetës, ato të dhimbshme që na shtyjnë drejt trishtimit: të mos lejojmë që të na e vjedhin shpresën!

Ta shikojmë edhe atë ylber. Autori ka dashur që t'ia ndryshojë ngjyrat origjinale, por edhe ai na kujton dhe u referohet realiteteve përfundimtare: ferrit, purgatorit dhe parajsës, gjëra për të cilat vështirë se flitet në ditët tona, por që janë pjesë e

Katekizmit të Kishës Katolike dhe që, pa frikë, por me fe dhe dashuri, duhet t'i reflektojmë dhe t'i meditojmë.

Vëllezër dhe motra, edhe ne marrim pjesë në lojën e shikimeve midis Nënës dhe Birit: ato na tregojnë se çfarë mirëkuptimi të thellë duhet të ketë midis nesh dhe Jezusit. Ashtu si midis Marisë dhe Krishtit mirëkuptimi shkon përtej asaj të lidhjes së gjakut për t'ia shtrirë një fafëmisie shpirtërore me gjithë njerëzimin dhe pastaj me gjithë hyjninë, kështu qoftë edhe të mirëkuptuarit tonë: *“vëllezër të gjithë”*, siç do të thoshte Papa Françesku, ndërmjetësues me Jezusin për këtë njerëzim.

Dora e majtë e Fëmijës që kap cepin e mantelit të Nënës, ndërsa me të djathtë kapet për qafën e saj, tregon se si hyjnorja kapet tek njerëzorja me një familjaritet që ishte i mundur vetëm në Krishtin. Ashtu si Maria, ta lëmë veten të përqafohem nga Krishti në mënyrë që të hyjmë në një marrëdhënie me Të dhe të jemi të dashur prej Tij. Por, në të njëjtën kohë, t'i lejojmë Krishtit që të kapet për ne për të kërkuar ndihmën dhe bashkëpunimin tonë në mënyrë që dëshira e Tij për të mirën e njerëzimit të gjejë në ne bashkëpunëtorë të gatshëm për veprën e ungjillëzimit: me Shën Palin, edhe ne përsërisim: *“Sepse, të shpall Ungjillin nuk është një arsye krenie për mua, është detyrë që më duhet ta kryej: I mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin”* (1Kor 9, 16).

Në fund, ta marrim parasysh ylberin e gjykimit hyjnor të cilit duhet t'i nënshtrohemi, por të cilit mund t'i bëjmë ballë me ndërmjetësimin e Krishtit që u bë njeri dhe me ndërmjetësinë e fuqishme të Marisë, e cila, ashtu si ne, ishte veshur me hyjninë e Birit.

Gëzuar festën, Shkodër! Zoja dhe Pajtoresha jonë marrtë për ne çdo hir dhe bekim nga Biri dhe ky popull përparofitë në rritjen dhe në zhvillimin e virtyeteve njerëzore, të cilat t'i rrënjosë mirë në vertytet shpirtërore.

Zoja e Shkodrës, lutu për ne.



Moter Marjeta Gjoka

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

QËNIA NJERËZORE NË TËRËSINË E SAJ
«[...] Hyji yt, të edukoi ashtu si edukon njeriu fëmijën e vet» (Lp 8, 5).



Bashkëveprimi i mendjes, zemres dhe trupit

Rëndësia e temës mbi edukimin është trajtuar shumë gjatë historisë në mënyra të ndryshme, gjë e cila është e evidente edhe në ditët e sotme. Edukimi konsiston në formimin e individit, ku, nëse individi është i mirë formuar ai ndikon edhe në relacionet mes individëve të tjerë dhe grupeve të ndryshme shoqërore. Formimi ka një rëndësi globale prandaj edhe Papa Françesku i kushton një vëmendje të madhe edukimit i cili manifestohet duke u nisur nga rëndësia themelore që ai i kushton personit. Është e evidente vendosmëria e tij për të kundërshtuar aspektet e shumta të reduksionizmit të përhapur, ai ndjen empati për disa dimensione të qenies njerëzore, por në të njëjtën kohë ai refuzon të tjerat që nuk janë as të rëndësishme dhe as vendimtare. E gjithë kjo duke iu referuar mikro-shoqërive lokale por edhe makro - shoqërisë planetare e cila sot kërkon nga ne të zgjerojmë sfidën e aferimitit me dimensionin – botëror në perspektivën e ekologjisë integrale, qëllimi është humanizimi i edukimit.

Të humanizojmë edukimin e kohërave tona

Siç e kam theksuar edhe me siper Papa Françesku i kushton një vëmendje të madhe edukimit dhe natyrisht detyrës së edukatorëve, e gjithë kjo manifestohet duke u nisur nga rëndësia themelore që i jepet personit,

nëpërmjet një vizioni pedagogjik. Gjithashtu është shumë e qartë vendosmëria për të nxjerrë në pah të dy horizontet e përmirësimit, domethënë aspektet vërtetë promovuese dhe edukative, dhe me shembuj efektivë mjetet dhe metodat e mundshme treguese që mund të ndihmojnë në mënyrë koherente në drejtimin dhe në përmirësimin e individëve dhe të shoqërisë. E gjithë kjo duke iu referuar mikro-shoqërive lokale aty ku afërsia është e afërt (duke filluar nga familja si një botë e vogël ku i përket edhe famullia), por edhe të shoqëria makro - planetare e cila sot kërkon që sfidën e jetës së ardhme ta zgjerojmë në një dimension botëror, në këndvështrimin e ekologjisë integrale. Qëllimi është që të humanizojmë edukimin, duke vlersuar në tërësi njerëzimin e qenies njerëzore, një njerëzim i zhytur në shpirtërim, ku qielli e toka takohen, dialogojnë dhe i referohen njëri-tjetrit në mënyrë reciproke.

Të humanizojmë edukimin duke u angazhuar për ta bërë atë integral dhe global me pak fjalë të shumanshëm, duke filluar nga disponueshmëria e menjëhershme për të takuar tjetrin si të afërm. Papa Françesku është padyshim një novator i aftë edhe në nivelin e gjuhës, dhe të fjalorit: përdor terma dhe koncepte që janë të njohura dhe të lehta për t'u kuptuar, dhe janë përtej një ngushtimit të anakronizmit dhe fushës së erudicionit steril dhe ekskluziv të vetë-referencës, ato marrin një rëndësi të



fortë dhe tregojnë implikime të qarta në nivelin e praktikës së veprimit edukativ. Disa nga këto koncepte janë plot histori, duke qenë tashmë të pranishme në veprat e pedagogëve të mëdhenj të së shkuarës, në të njëjtën kohë janë pjesë e fjalorit pedagogjik të sotëm. Pra, ato paraqesin një dendësi kuptimore të pasur dhe të thellë, e cila gjithsesi i bën këto ide të forta të kapërcejnë, pa e tradhtuar fare, nga sfera e thjeshtë e fjalëve të përditshme dhe në të vërtetë popullore, për t'i ngritur në dinjitetin pedagogjik dhe themelor. Fjalë të cilat me të drejtë janë edhe pjesë e një leksiku të specializuar të lindur nga historia, kërkimi dhe reflektimi i vërtetë. Nga ana tjetër, ato janë koncepte aq domethënëse, duke pasur parasysh rritjen e tyre të rëndësishme historiko-kulturore, sa që mund të shpërndajnë forcën e tyre autentike semantike, një energji aluzive dhe pragmatike që mbart dhe përcjell tek të tjerët. Këto koncepte, për më tepër, pasurohen me vlera dhe kuptime të mëtejshme përmes rrjedhës që i përcjell Papa Françesku duke i aktualizuar ato: janë fjalë në shumë mënyra të lashta të cilat, megjithatë, shihen, kuptohen dhe ripropozohen brenda sfidave të sotme, domethënë në një marrëdhënie me një skenar të ri kulturor e pedagogjik, në shumë raste të pazakontë, kompleks, dhe i vështirë: një skenar antropologjik që përfshin paradigma të reja, interpretuese dhe semantike, gjithashtu praktika të reja. Duke ecur me kohën nënkupton rinovimin e vazhdueshëm të shpalljes, dhe kjo mund të ndodhë jo aq shumë duke zëvendësuar fjalët, sa duke ju caktuar vetë fjalëve horizonte të mëtejshme interpretuese.

Intelekt, Zemer, dhe Trup

Shembulli specifik që synoj t'i referohem janë pikërisht tre dimensionet, *intelekt, zemer dhe trup*, që Papa Françesku na bën thirrje në reflektimet e tija mbi edukimin, në veçanti kur ai takohet me universitete të ndryshme. Në fakt do angazhohem të vë në pah disa nga fjalimet e tija, me 17 janar 2018, në fjalimin që ai mbajti në Universitetin Katolik në Çile në rastin e vizitës apostolike, foli për një edukim që integron dhe harmonizon intelektin, ndjenjat dhe veprimin ose më qartë që harmonizon mendjen, zemrën dhe duart. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur që nxënësit të rriten në mënyrë harmonike jo vetëm në nivel personal, por në të njëjtën kohë edhe në atë shoqëror. Duke e ditur mirë se ndarja e njohurive dhe gjuhëve, analfabetizmi i integritetit dhe i dimensioneve të ndryshme të jetës, nuk prodhon gjë tjetër veç ndarje dhe shpëputje shoqërore. Në këtë këndvështrim është e nevojshme të gjenerojmë një ndërveprim midis klasës dhe ditorisë së njerëzve, të prodhojmë një sinergji pasuruese midis ashpërsisë shkencore dhe intuitës popullore, sepse vetëm ndërveprimi i ngushtë reciprok parandalon ndarjen midis arsyes dhe veprimit, midis të menduarit dhe ndjenjës, midis njohjes dhe të jetuarit, midis profesionit dhe shërbimit. Kjo pedagogji e harmonisë ndërmjet dijes dhe aftësive njerëzore shprehet edhe si pedagogji e harmonisë shoqërore, si aftësi për të përparuar në komunitet, dhe për të aktualizuar vetveten si një popull,

si një familje, si një komb dhe në të njëjtën kohë, si një e ardhme, që gjenerojmë procese të cilët ndriçojnë kulturën aktuale duke propozuar një humanizëm të rinovuar që shmang rënien në çdo lloj reduktimi.

Është e vetmja mënyrë në ditët e sotme, për tu zgjidhur nga një shoqëri e lehtë, nga një hapësirë heterike e identitetit total, dhe e mospërputhjes sociale dhe kulturore. Dëshiroj të nënvizoj këto koncepte të cilët që në ditët e para të pontifikatit të tij Papa Françesku i komunikon dhe i përsërit disa herë radhazi me një këmbëngulje të barabartë me bindjen e tij. Për shembull, me 10 maj 2014 e përkufizon edukimin si një rrugë që i bën të rriten tre gjuhët që një person i pjekur duhet të jetë në gjendje ti flasë: gjuhën e mendjes, gjuhën e zemrës dhe gjuhën e duarve. Me 5 shkurt 2015 flet për harmoninë mes gjuhës së personit: asaj të duarve, të zemrës dhe të mendjes. Pak muaj më pas me 21 Nëntor shprehët, thotë se ekzistojnë tre gjuhë: gjuha e kokës, gjuha e zemrës dhe gjuha e duarve, edukimi duhet të ecë në këto tre rrugë. Me pak fjalë në fjalimet e Atit të Shenjtë shfaqen shumë shpesh tre fjalët *mendje - zemër - duar*, dhe nënvizon vazhdimisht fjalën *harmoni*. Edukimi është në fakt një përvojë krijuese që gjithmonë përfshin në mënyrë harmonike të tri gjuhët: mendoni se çfarë ndjeni dhe çfarë bëni; ndjeni mirë atë çfarë mendoni dhe atë çfarë bëni; dhe të bëni mirë atë çfarë mendoni do të thotë që ju po veproni ashtu siç e ndjeni. Të tre gjuhët duhet të ecin së bashku dhe në harmoni. Mund të themi mirë se vizioni i personit si një tërësi integrale përfshin një theksim të tillë në artikullimin e pjesëve, secila prej të cilave padyshim karakterizohet nga një specifikë funksioni, e cila megjithatë shprehet në mënyrë të plotë vetëm në harmonizimin e përgjithshëm. Siç vihet re fjala harmoni për Papa Françeskun ka një vlerë të fortë ekzistenciale, sociale, pedagogjike, aq sa më duket legjitime të përdor për këtë propozim përkufizimin e harmonisë së pedagogjisë.

Mendimi i Papa Françeskut dhe i autorëve bashkëkohorë

Ajo çfarë ka theksuar Papa Françesku pajtohet me atë që është thënë nga autorë të njohur bashkëkohorë që në mënyra të ndryshme e kanë kritikuar ndarjen e identitetit që prek veçanërisht kulturën perëndimore, por që, si rezultat i proceseve të globalizimit, tani duket se po përhapet në një dimension planetar. Afrimi i mendimit të tyre na lejon të sqarojmë më tej vizionin e Papës në një lojë të ngjashmërive dhe e dallimeve. Edgar Morin në reformën e mësimdhënies dhe reforma e mendimit, propozon një edukim të bazuar mirë që ndihmon në formimin e një "koke të mirëbërë" të aftë për mendimet komplekse, dhe për të kuptuar kërkesat dinamike të ndërvarësisë planetare. Niset nga kritika e fortë ndaj atyre koncepteve dhe praktikave mësimore që, veçanërisht në mjedisin shkollor favorizojnë të menduarit e fragmentuar. Ai pohon se inteligjenca që di vetëm të shpresojë e thyen të gjithë botën në copa të ndara, ndan problemet njëdimensionale dhe shumëdimensionale. Ky lloj mësimi shfaqet i dëmshëm jo vetëm për rezultatet e menjëhershme në fushën e dijes,



të njohurive shkencore në përgjithësi, por edhe nga pikëpamja e përgjegjësisë etike, pasi një inteligjencë e paaftë për të marrë në konsideratë kontekstin dhe kompleksin planetar e bën atë të verbër të pavetëdijshëm dhe të papërgjegjshëm. Fragmentimi i njohurive, me një këmbëngulje vërtetë të tepruar për sasi të mësimore që lidhen me nocione brenda sektorëve të veçantë, bazohet pikërisht në një angazhim anomal të bagazhit nocionistik, e cila ka supozimin e transmetimit të kaq shumë njohurive, por që në të vërtetë, tradhton vetë detyrën e mësimdhënies: ajo formon vetëm një kokë shumë të plotë, në të cilën njohuritë grumbullohen, dhe nuk kanë një parim heshtjeje dhe organizimi që i jepet kuptim. Dija është pa dyshim ndarje dhe ndërlidhje, analizë – sintezë, megjithatë qytetërimi ynë sasi dhe praktika pedagogjike që e mbështet atë përfundojnë duke e privilegjuar qartë fazën e ndarjes. Rezultati i këtij veprimi, të cilit ne shpesh jemi mbështetës të padashur, është një kulturë skizofrenike dhe dritshkurtër, e aftë për të theksuar të veçantën, por në të njëjtën kohë, të përshtatshme për të kuptuar sfidën tokësore: e kundërta e asaj që duhet të promovojë një pedagogji autentike, misionin e mësimdhënies shkruan Morin është të transmetojë jo njohuri të pastër, por një kulturë që na lejon të kuptojmë gjendjen tonë dhe na ndihmon të jetojmë, është në të njëjtën kohë një mënyrë e të menduarit në mënyrë të hapur dhe të lirë. Prandaj, ne duhet t'i japim jetë një mësimi të aftë për të formuar gjerësi dhe për të kontekstualizuar dhe globalizuar njohuritë, përmes fuqisë së të menduarit ekologjik, sepse kjo është një cilësi themelore e mendjes njerëzore, është një çështje për ta zhvilluar atë në vend që ta atrofizojmë atë. Arti i mësimdhënies, duhet të përfitojë nga shumfishimi për të përforcuar unitetin: duhet t'i ngjajë atij paleontologut ose studiuesit të parahistorisë, të cilët na interpretojnë: artin e detajeve që duken të parëndësishme në të dhënat e tyre por që në vetvetë lejojnë rindërtimin e një historie të tërë. Shkollat, në radhë të parë, duhet të përmbushin detyrën urgjente të edukimit për epokën planetare: njohja e unitetit në kuptimin e diversitetit, njohja e unitetit njerëzor përmes diversitetit kulturor, diversiteti individual dhe kulturor përmes unitetit njerëzor (Krh. Edgar Morin, *Koka e formuar mirë reforma e mësimdhënies dhe reforma e mendimit*, fq. 6 - 20).

Në këtë pikë mund të themi fare mirë se mendimi pedagogjik i Morinit dhe ajo e Papa Bergoglios bien dakord për kritikën e kulturës

njëdimensionale dhe për nevojshmërinë e një ekologjizimi kulturor dhe pedagogjik. Megjithatë, besoj se Morin duke i dhënë arsye titullit të tekstit të tij, fokusohet veçanërisht në kokën e formuar mirë, pra në dimensionin e mendjes, duke i lënë pak pas dore zemrën dhe duart, edhe nëse duhet pranuar se në disa pjesë të shkrimeve të tij ai këmbëngul në detyrën etiko-edukative të formimit të qytetarëve mbështetës dhe të përgjegjshëm për mësimdhënien e qytetarisë tokësore, karakteristikë e epokës planetare në të cilën të gjithë njerëzit përballen me të njëjtat probleme jetësore të vdekshmëve. Megjithatë, mbetem me përshtypjen se edhe për sa i përket dimensioneve pedagogjike që i hapen ndërkulturës sociale në nivel global, Morin nënvizon shumë më tepër aspektet njohëse dhe në lidhje me të mësuarit e përmbytjes sesa ato sociale afektive, të cilat më vendosmërisht aludojnë në marrëdhëniet ndërpersonale dhe të komunitetit. Ai thekson ekologjinë e mendjes e cila lejon një "kokë të formuar mirë". Pozicioni i Morinit do kishte qenë më i përafërti me pozicionin e Papa Françeskut, nëse do i jepte të njëjten rëndësi edhe "zemrës së formuar mirë", me pak fjalë siç i atribuonte rëndësi "kokës së formuar mirë". Zygmunt Bauman lëviz nga një këndvështrim tjetër kërkimor, sipas të cilit shoqëria jonë thekson dinamizmin epidermal të rrjedhës dhe jo dimensionin e thellë të pauzës së besnikërisë ndaj njerëzve dhe ndaj detyrës. Për të, përvoja intime e lidhjes autentike duhet të zotërojë një dendësi antropologjike, një qëllim i fortë i nënkuptuar një përcaktim i saktë relacional është zëvendësuar nga paqëndrueshmëria në lidhje me tjetrin. Lidhjet njerëzore janë zëvendësuar nga marrëdhëniet kuptimplota





njerëzore dhe kërkojnë pjekuri dhe përkushtim. Më duket se perspektiva e Baumanit, në krahasim me atë të Morinit, është më e vëmendshme për të kuptuar sfidat e etikës brenda globalizimit. Ai drejton gishtin drejt brishtësisë së sotme të strukturës shoqërore, duke u nisur nga pasiguria e marrëdhënieve parësore themelore, dhe nënvizon dëshirën për të qenë të bashkuar dhe nevojën rrjedhimore për të ndërtuar lidhje domethënëse në një nivel ndërpersonal, social dhe ndërkulturor. Synimi i tij është të favorizojë kalimin e shumfishimit të fragmentuar në shoqërinë dialoguese. Bauman shkruante, njerëzimi bashkëkohor flet me shumë zëra dhe unë do të vazhdoj ta bëj këtë për një kohë shumë të gjatë. Pyetja qendrore e epokës sonë, si ta shndërrojmë këtë polifoni në harmoni dhe ta parandalojmë që ajo të degjenerojë në të keqe. Por harmonia e njerëzimit është e ndërtuar ekskluzivisht me gëlqere dhe me tullat e dashurisë dhe angazhimit njerëzor, (krh. Zygmunt Bauman, 2001, fq. 123 - 125).

Prandaj, angazhimi i përbashkët është gjetja e unitetit në diversitet, një detyrë e mundimshme ka qenë shumë herë gjatë historisë, por e pranishme më shpesh në deklaratat e qëllimit sesa arritjet aktuale: mes unitetit dhe diversitetit midis homologimit dhe diferencimit nuk ka pasur kurrë një reciprocitet të vërtetë dhe konstruktiv, sepse njëri i ka lënë vendin tjetrit gjithmonë dhe në mënyrë të alternuar, në mënyrë fituese dhe humbëse. Gjithashtu në lidhje me këtë qëllim të emancipimit social dhe ndërkulturor, të unitetit në diversitet, Bauman propozon një strategji të mundshme: që të ulen armët duke pezulluar përleshjet kufitare të luftuara për të mbajtur larg të huajin, duke kërkuar shembjen e mureve të vogla të Berlinit që ngrihen çdo ditë për të mbajtur larg njerëzit dhe për t'i ndarë ata, duke thyer barrierat, duke krijuar lidhje, duke jetuar përvojën humanizuese të afërsisë. Në të njëjtën kohë, duke përmbysur tendencat homologuese, të theksuara nga globalizimi, drejt izolimit solipsist dhe përhapjes së modaliteteve ekzistenciale jopersonale dhe anonime, duhet të kuptojmë se nevojitet të kërkojmë një rrugë drejt një kishe vërtetë autonome e bashkuar dhe e gjallë, ku njerëzit takohen çdo ditë për të vazhduar përpjekjen e përbashkët të traditës midis gjuhëve të interesave private dhe të mirës publike. Këto janë qëllime sociale, kulturore dhe politike, por më parë ato janë pedagogjike, të cilat mund të ndiqen me sukses vetëm përmes vendosmërisë së përgjegjshme të njerëzve dhe komuniteteve që dinë të rikuperojnë, mbi të gjitha nëpërmjet një veprimi edukativ inteligjent, ndjenjën e një rruge integrale, të aftë për të ndërthtur nevojat e personit, unike dhe të papërsëritshme, dhe atë të përkatësisë në komunitetin njerëzor. Mund të themi që në veprën e gjerë të Baumanit, na len për të kuptuar që reflektimi i tij mbi unitetin e shumëfishtë dialektik është më i përafërt me mendimin e Papa Françeskut, pikërisht sepse fokusohet në aspektin relational, do të thojë në aspektin e zemrës. Papa e do dialogun siç do të vërtetën, sociologu e vlerëson teorinë e dialogut të Papa Françeskut, aftësinë e tij për të marrë parasysh se bota

jonë është një botë polifonike: Papa di të thotë fjalë aktuale dhe koherente dhe paraqitet me veprime krejtësisht alternative ndaj formave shumë të zakonshme të dialogut të rremë, tek monologët dhe episodet e shumta të kaluara si dialog. Papa Françesku jo vetëm që predikon nevojën për dialog, por e praktikon atë. Një dialog të vërtetë, mes njerëzve me këndvështrime të ndryshme. Dhe këtë e bën duke ditur se dialogu do të thotë afrimi dhe respektimi i diversitetit, njohja e palës tjetër, në një dinamikë të të dëgjuarit armiqësor ndaj plotfuqishmërisë së mendimit të vetëm është vërtet i disponueshëm për pluralitetin e zërave, duke e ditur mirë se përdorimi i fjalës së vërtetë në njëjës në një botë polifonike është si të duash të duartrokasësh me një dorë. Me një dorë mund të japësh një shuplakë, por jo të duartrokasësh. Në fund të fundit, Papa Françesku është një duartrokitje e singertë, një dëshmitar i besueshëm sepse mbyllja mbrojtëse në një zonë rehatie nuk lejohet sot, sidomos për të ardhmen e njerëzimit të cilet ndodhen në një botë të pakthyeshme multikulturore dhe multicentrike, duhet të kemi të qartë se pranimi i dialogut është një çështje jete. Një dialog që harmonizon dallimet pa i mohuar ato, dhe duke i vendosur ato në lojën dinamike të një marrëdhënieje që është krijues në vetvete dhe gjeneron jetë. Një dialog është në gjendje të nxjerrë në pah funksionin e pazëvendësueshëm të zemrës.

Ne kemi konsideruar kështu, në një krahasim sintetik të afiniteteve dhe dallimeve të parë në një këndvështrim sinkronik, se si ekologjia integrale e Papa Françeskut lidhet me dy autorët e rëndësishëm të ditëve tona, që janë Morin dhe Bauman. Sigurisht që mund t'i pasurojmë këto seri përsa i përket mendimit pedagogjik bashkëkohor. Mjafton të mendojmë, për shembull, për antropologjinë e dialogut "Unë" dhe "Ti" të Martin Buber, i cili kritikon copëzimin e fragmentuar dhe antidialogjik të kaq shumë propozimeve edukative-didaktike pikërisht nga respekti për unitetin ekzistencial të personit, ose pedagogjinë e të shtypurve të Paulo Freire, që është një pedagogji e fjalës e shikuar si një integritet dinamik i mendimit dhe veprimit. Ekzistenca joautentike e duhur për marrëdhënien "Unë" - "Ai" për Buber është edukim depozitues dhe shtypës, për Freire, ato janë shembuj të mrekullueshëm të disëharmonisë: marrëzia e njeriut që tjetërsohet në gjëra dhe nuk e gjen më veten, për Buber, është padrejtësia e një pushteti kulturor e pedagogjik që ndan mendje-zemër-duar, duke u caktuar të fuqishmëve aftësinë patologjike të të menduarit, njohjes, udhëheqjes, vendimmarrjes.

Besoj se këshillat pedagogjike të Papa Françeskut mund të jenë një ndihmë vërtet e besueshme për të çmuar idetë tona që përshkojnë jetën tonë dhe që angazhojnë mendjen tonë, zemrat tona, duart tona, të na mësojnë të ndërtojmë habitatin tonë dhe ta bëjmë atë më korresponduese me nevojat tona më autentike.

(Krh. G. MILAN, « Për një "pedagogji harmonie" dialogu mendje - duar - zemër», në *educatio catholica*, IV, 1 (2018) 25-33.



HOMELIA

Në 5 vjetori e Lumnimit të Martirëve tanë nga Imzot Angelo Massafra

Shkodër, 5 nëntor 2021

Ky pesëvjetor i Lumnimit të Martirëve tanë na gjen edhe një herë të mbledhur rreth tryezës së Fjalës dhe të Bukës Eukaristike për të vazhduar, me jetë tonë personale dhe atë bashkësiore, përvojën e bashkimit me Krishtin Mbret, që ata patën përpara nesh; në fund të fundit, ky është qëllimi drejt të cilit secili prej nesh duhet të priret çdo ditë dhe në këtë ecje ata qëndrojnë para nesh si fenerë ndriçues, që na tregojnë rrugën për të ecur: atë të besnikërisë ndaj Zotit Jezu Krisht.

Leximi i parë na ka treguar për një faqe të trishtë në historinë e popullit të Izraelit, shumë e ngjashme me përvojën që populli ynë ka jetuar gjatë kohës së përndjekës së fesë, që Martirët tanë e përjetuan në lëkurën e tyre dhe shumë prej të pranishmëve ende e kujtojnë shumë qartë këtë gjë. Përvoja që liria e rigjetur e kultit, me kushtet e ndryshuara të jetës së popullit tonë, mund të ndikojë që të rinjtë të mos i njohin apo të mos i kushtojnë vëmendjen e duhur këtyre gjërave, me rrezikun se mund të biem sërish në skllavëri... ndoshta jo në atë të një diktatori, por të një diktature mendimi që kalon nëpër kanalet kulturore të ditëve tona, për të cilën flasin qoftë Papa Emerito Benedikti XVI qoftë Papa Françesku. Në fakt, ka një atmosferë lirie, por duket se liria është bërë shkak për përhapjen e modave të rrezikshme që minojnë besnikërinë tonë ndaj Krishtit dhe mësimet e Tij.

Sidomos më të rinjtë, të pavetëdijshëm për rrezikun, rrezikojnë të përfshihen në këtë skllavëri jo të dukshme dhe të fshehur në mirazhin e një mirëqenieje që duhet fituar me çdo kusht: eksterioriteti në kurriz të brendësisë, seksualiteti në kurriz të afektivitetit, argëtimi në kurriz të lumturisë që konsiston në bërjen e asaj që është e drejtë dhe jo të asaj që plotëson një nevojë imediate. Me rrezikun gjithashtu që, për të arritur qëllimet e veta, njeriu mund të përdorë dhunën dhe trafikun e paligjshëm.

Përndjekja që po bëhet sot ndryshon, ndoshta, format e saj të agresionit, por fuqia e saj shkatërruese mbetet e pandryshueshme. Na takon neve inteligjenca e fesë për të identifikuar rreziqet dhe për t'u ikur atyre. Por kjo është e mundur vetëm nëse i qëndrojmë besnikë Krishtit, nëse dëgjojmë dhe meditojmë Ungjillin e Tij, nëse gjejmë kohë të ndalemi para Tij të pranishëm në Tabernakull dhe ta lejojmë të flasë, në mënyrë që t'i kuptojmë dhe të vendosim për gjërat e jetës sonë.

Në fakt, ajo që duhet të na shqetësojë më shumë nuk është përndjekja: ka qenë gjithmonë dhe gjithmonë do të jetë; por aftësia jonë për t'i qëndruar besnikë Krishtit sot, siç thotë Ungjilli: "Kushdo, pra, pranon para njerëzve se është imi, edhe unë do të



pranoj para Atit tim që është në qiell, se jam i tij". Kjo duhet të jetë e rëndësishme për ne! I përkasim Krishtit dhe dëshmojmë me gëzim përkatësinë tonë ndaj Tij.

Çfarë na sjell fakti që i përkasim Krishtit? Po në njetin verset Ai vetë na e zbulon këtë gjë: të njihemi para Atit si "të Krishtit" në ditën që do të dalim përpara lavdisë së Tij. Atë ditë, ndoshta, nuk do të kemi gjëra të mëdha për të marrë me vete; ndoshta nuk do të kemi vepra të mëdha meritore për të paraqitur: me siguri do të paraqitemi përpara Zotit me të vërtetën e vetvetes. Dhe nëse e vërteta e vetvetes është ajo e besnikërisë sonë ndaj Krishtit dhe Ungjillit të Tij, atëherë nuk kemi pse të frikësohemi, por përkundrazi do të kemi shumë për të gëzuar. Lumturia jonë e përjetshme do të jetë, duke përdorur imazhin që na propozoi Shën Gjoni si shembull në leximin e dytë, duke qenë ditë e natë përpara fronit të Zotit, përfundimisht i lirë nga çdo dhimbje.

Por kjo është koha e punës: është koha e mbjelljes së bërë me vështirësi, koha e misionit. Në fakt, nuk mund ta imagjinojmë se i përkasim Krishtit dhe se zbatojmë Ungjillin e Tij, nëse nuk kemi në ne dëshirën për të arritur lumturinë e përjetshme së bashku me sa më shumë njerëz, duke i ndihmuar ata të takojnë Krishtin. As nuk mund të mendojmë se i mjaftojmë vetes sonë; kemi vepra trupore dhe



shpirtërore të mëshirës për të bërë: ato janë misioni ynë në këtë tokë.

Në të gjitha këto, nuk duhet të kemi frikë se nuk do t'ia dalim, sepse nuk jemi vetëm: jemi një bashkësi feje, Kisha e Krishtit, Trupi mistik i Krishtit, i cili vazhdon ta bëjë të pranishëm Mësuesin dhe Zotin e tij në çdo kohë dhe në çdo vend.

Statistikat e publikuara javën e kaluar tregojnë se, me përjashtim të Evropës, katolikët në botë janë rritur me 15 milionë e gjysmë. Është një e dhënë statistikore që nga njëra anë na gëzon, por nga ana tjetër, duhet të rritet në ne ndjenjën e përgjegjësisë; si dhe duhet të na bëjë të reflektojë fakti se Evropa po bëhet gjithnjë e më e pandjeshme ndaj aspektit të fesë...dhe ne jemi Evropa!

Sot më shumë se kurrë, duhet t'i bashkojmë forcat për ta përmirësuar përvojën tonë si nxënës të Krishtit të mbledhur në Kishën e Tij. Kjo është arsyeja pse Ati i Shenjtë, Papa, e ka dashur këtë Sinod që do t'i përfshijë të gjithë të krishterët, duke filluar nga famullia më e largët në botë deri te metropolet më të mëdha.

Në fakt, fjalët e këtij Sinodi janë: Bashkim, Pjesëmarrje-Bashkepërgjegjësi dhe Mision; për të ritheksuar atë që po thoja pak më parë: nuk jemi

vetëm në kryerjen e Misionit të Krishtit, por një bashkësi e gjallë e krishterë që vepron dhe punon.

Së bashku do të kujdesemi për ruajtjen e besnikërisë sonë ndaj Krishtit; së bashku do të përpiqemi t'i kuptojmë kufijtë tanë dhe ato të botës në të cilën jetojmë, në mënyrë që t'i kapërcejmë ato dhe të përmirësojmë veten; së bashku do ta shpallim fenë tonë, me gëzim dhe guxim, rrugën e njerëzimit drejt Krishtit, Mbret dhe Zot.

Përkujtimi i këtyre pesë viteve nga Lumnimi i Martirëve nuk mund dhe nuk duhet të jetë një përvjetor i thjeshtë, pas të cilit, secili prej nesh kthehet i lumtur në shtëpinë e vet, por marrja e një angazhimi serioz: atë të ripërtëritjes së fesë sonë, të përkatësisë sonë ndaj Krishtit në Kishë, të misionit tonë personal dhe bashkësior për ta çuar botën te Krishti dhe atë të angazhimit të të gjithëve: familjet, të rinjtë, meshtarët dhe motra për thirrjet mesharake dhe rrugëtare-misionare.

Martirët tanë na ndihmofshin, me ndërmjetësimin e tyre, në këtë ecje sinodale dhe gjatë gjithë jetës sonë dhe sëbashku me ta themi:

Rroftë Krishti Mbret!



GJENDJA SHPIRTËRORE E REFUGJATËVE DHE EMIGRANTËVE

Muzeu Kombëtar, 8-10 nëntor 2021

Ëndrrat që mbartim

Njeri i lirë, që jeta jote është një rrugëtim i vazhdueshëm në kërkim të jetës, të “tokës së premtuar”! Njeri i lirë, që në rrugëtimin tënd, në valixhen që shtrëngon fort ndër duar e ke mbushur plot ëndrra për një jetë më të mirë! Një udhëtim pa kthim si populli i Zotit i udhëhequr nga Moisiu, duke ecur për dyzet vite në shkretëtirë për të mbërritur në Izrael, në Tokën e Premtuar..!

Një paralelizëm kaq i fortë ndërthur natyrën e njeriut me atë të territoreve të shkelura, që shndërrohet në simbol të dinamikës së brendshme të shpirtit të tij. Ashtu si larmia e gjeografisë së përshkuar është magjepsëse, po aq dhe e mundimshme e njëkohësisht tragjike është ecja me ditë, javë dhe muaj të tërë pandalur të këtyre njerëzve që brenda tyre pushtohen nga pasiguri dhe ankthe të forta.

Në të vërtetë kjo është gjendja shpirtërore e refugjateve dhe emigrantëve që gjenden aktualisht në Shqipëri, të gatshëm të lejnë pas jetën që jetuan në vendet e tyre të origjinës për të nisur, falë një udhëtimi të mundimshëm nëpër territore të vështira, mes pyjeve, aventurën e një jete të re plot të panjohura.

Një jetë të re nga asgjë, por që gjejnë reflektim dhe mbështetje nëpër rreshtat e misionit të Caritas Shqiptar: Ne besojmë në vlerën e dinjitetit të jetës njerëzore. Ne ndihmojmë duke u bazuar në vlerat shpirtërore dhe humanitare. Besojmë që çdo njeri ka të drejtë të jetë i përfshirë në vendime që kanë ndikim në jetën e tyre. Ne besojmë se respekti për të drejtat e njeriut do të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm.

Një qasje kjo që hedh vështirimin larg në kohë. Në një kohë pakohë, pasi tema qendrore e ekspozitës është migrimi dhe kalvari i të gjithë atyre që janë pjesë e kësaj lëvizje, shpërngulje njerëzore të cilët kanë mbërritur vitet e fundit në territorin shqiptar. Ekspozita vjen si një imazh tërësor i këtij fenomeni kaq të ndjeshëm dhe të prekshëm në bashkëkohësinë që jetojmë falë fotografive të fotografit Renuar Locaj. Imazhe të cilat duken sikur dalin nga rreshtat e një romani me skena biblike, ku fotografi nëpërmjet objektivit të aparatit të tij ka arritur të përjetësoi skena të



larmishme të mbërritjes së refugjatëve, azilkërkuesve dhe emigrantëve nga vendet e Lindjes kryesisht sirianë, irakenë, sudanezë, egjiptianë dhe afganë. Një seri fotografishë artistike, ku shihet qartë dhimbja e qenies njerëzore për t'u kapur fort pas jetës dhe për jetën.

Fotografitë janë një himn për jetën sesa një “lëmosh” figurative e metamorfozës së qenies njerëzore. Imazhet rrugëtojnë në kohë dhe çaste të ndryshme, ku portretet e fëmijëve, grave, burrave, familjeve apo gjyshit me mbesën shpërfaqin një dramë të tejskajshme njerëzore. Një dramë të cilën Renuar Locaj e ka evidentuar duke kllapitur dhimbje në sytë e tyre, në pasigurinë për të tashme dhe për të ardhmen e zhytur në errësirën e verbër. Ekspozita nuk sjell vetëm dhimbjen dhe imazhin e një fenomeni kaq dramatik siç është migrimi brenda mureve të një muzeu sesa përcjelljen e mesazheve të forta dhe kuptimpolta, duke i ndërthurur ata me elementë origjinal të jetuar e të sjellë me vete nga vetë ata. Shputa e këmbëve të tyre është dëshmia më e dhimbshme e rrugëtimit të gjatë ku ata kanë shkelur e shprehur në heshtje në formë onomatepesh. Braktisja e vatrës, lidhja fizike dhe shpirtërore me atë tokë, i vendit ku këta njerëz kanë lindur është pengi i tyre më i pashlyeshëm për të ardhmen që i pret.

Si t'i interpretojmë atëherë këto drama njerëzore? Cilat mjete analitike duhet të përdorim për të rindërtuar fizionominë e fenomenit të migrimit?

Rasti i Shqipërisë mbi të gjitha është dëshmia e mikpritjes pakushte ndaj një problemi humanitar që detyron secilin prej nesh të marrë përgjegjësinë për



një fenomen që e ka origjinën në mohimin e të drejtave, të mundësive të barabarta për punësim, pamundësia e dinjitetit njerëzor si pasojë e luftimeve civile, diskriminimit, zhvillimit kulturor-intelektual dhe kërcënimit të jetës së këtyre refugjatëve dhe migrantëve për të jetuar si të atillë në vendet e tyre. Prandaj, aftësia jonë për t'iu përgjigjur kërkesës për mbrojtje sociale, drejtësi dhe të ardhme të këtyre njerëzve bëhet urgjente, duke pranuar dhe njohur vuajtjet e tyre, duke iu përshtatur nevojave që ata kanë në bazë të respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, ku padyshim rol themelor luajnë edhe detyrimet tona ligjore si vend pritës. Një sfidë kjo e përbashkët, duke u përpjekur për të qenë më pranë, aty ulur përkrah fatit të tyre, pasi rrugëtimi që ata kanë ndërmarrë shkon përtej Shqipërisë.

Kjo ekspozitë vjen si rrëfim i një realiteti të dhimbshëm që Renuar Locaj përçon me fotografitë e tij. Fotografi të cilat flasin më shumë sesa deklaratat, synimet dhe parimet mbi drejtësinë, paqen apo solidaritetin nga përfaqësuesit e ndryshëm ndërkombëtar. Përfshirë këtu zërin e mediave dhe intelektualëve, pasi mos pranimi apo refuzimi i refugjatëve dhe emigrantëve në thelb e bën shoqërinë bashkëkohor perëndimore më të ftohtë, më indiferente, pse jo më të ashpër, duke mos i ofruar ndihmë konkrete “këtu dhe tani” këtyre njerëzve në kërkim të një jete më të mire, me valixhen e tyre bosh ndër duar mbushur me ëndrra.

Radhë këto që synojnë të jenë një mjet njohës i

fenomenit të lëvizjes njerëzore nga vendet e Lindjes gjatë viteve të fundit në Shqipëri. Një reflektim që kërkon kapërcimin e stereotipeve dhe paraqikimeve që shoqëria shqiptare ndoshta ka kundrejt “tyre”.

Ekspozita e fotografisë pasurohet edhe me sende si; veshje, këpucë, fotografi të marra me vete nga emigrantët si kujtim i një kujtese që brenda tyre nuk do të shuhet asnjëherë, por përkundrazi do të mbetet brenda tyre si imazhi që ata identifikojnë të shkuarën e tyre. Të gjitha këto elementë semiotik ngrejnë një monolog-dialog midis fotografive, sendeve të ekspozuar në formë instalacioni dhe publikut shqiptar. Një mënyrë kjo ndërvepruese mes tyre, por mbi të gjitha për të sjellë në vëmendje të shkuarën tonë të afërt, ku edhe ne dikur përjetuam një dramë të tillë sikundër ata sot në Shqipëri.

Për dashuritë dhe shpirtin e braktisur në tokat e lëna pas, ndaj utopive dhe në ndjekje të ëndrrave për dhimbjen në sytë e tyre, për plagët në shputat e këmbëve, djegur shkretëtirave të pakufishme, të etur brigjeve të detit të përshkuar, atyre që fundin prekën, për buzëqeshjet e tyre, dhe atyre që janë ndalur buzë shpresës.

Në të vërtetë në shtëpinë e të gjithëve ne, pasi shtëpia e shqiptarit është e Mikut dhe e Zotit.

Ph.d. Oltsen Gripshi
Kurator i ekspozitës



ATË GJON SHLLAKU DHE ATË ANTON HARAPI

Ndërhyrja e Imzot Angelo Massafra-s

Me rastin e 75-vjetorit të vdekjes së të lumit Atë Gjon Shllaku dhe të Atë Anton Harapit

Ju përshëndes të gjithëve ju që merrni pjesë në këtë veprimtari në kujtim të dy kolosëve të Familjes Françeskane të shekullit të kaluar në Shqipëri: *“T’u këndojmë lavde burrave të përmendur, të parëve tanë sipas breznive të tyre. Disa të tjerëve kujtimi s’u mbeti, u harruan sikur të mos kishin qenë, kanë lindur sikur të mos kishin lindur, po ashtu edhe bijtë e tyre pas tyre. Por këta ishin njerëz të përsëritshëm, veprat e mira të tyre nuk ranë në harresë”* (Sir 44,1.8-10).

Kështu libri i Siracidit, në kap. 44 dhe rreshtat 1-10, kujton veprat e atyre që e bënë Izraelin të madh falë fesë së tyre dhe na autorizon që edhe ne t’i kujtojmë ata që na paraprinë në këtë histori, duke bërë që të jemi sot ata që jemi.

Për këta arsye, dëshiroj të ndërhyj për të dhënë kontributim tim në kujtimin e të Lumit Atë Gjon Shllaku dhe të Atë Anton Harapit, të paktën për sa i përket interesimit tim të drejtpërdrejtë për Kongregatën për Çështjet e Shenjtërve në funksion të lumnimit që kemi kremtuar në vitin 2016 në Shkodër.


Me atë rast, si para dhe pas, disa herë dhe nga persona të ndryshëm, më kanë pyetur në lidhje me mospërfshirjen në listën e të Lumëve të Atë Anton Harapit. Ndoshta ky është rasti më i përshtatshëm për të dhënë një përgjigje të qartë dhe zyrtare.

Para së gjithash duhet kujtuar se lista e kandidatëve për Lumnim është hartuar dy herë: MEE 10 tetor 1994 nga Ipeshkvijtë e atëhershëm të saposhuguruar nga Gjon Pali II; dhe në vitin 2001, në funksion të fillimit të menjëhershëm të itinerarit që duhej ndjekur për Procesin e Lumnimit. Atë Harapi nuk ndodhej në listën e parë. Në të dytën u vendos qëllimisht që të mos futej, sepse, duke qenë plotësisht i përfshirë në veprimtarinë politike të vendit, kjo përfshirje e tij mund të kishte ngadalësuar Çështjen e lumnimit të të tjerëve. Kjo gjë u bë me sugjerimin e Postulacionit.

Ipeshkvijtë, në mbledhjen Plenare të Konferencës, pasi hartuan listën e 38 emrave si kandidatë për nderimet e altarëve, kane hartuar edhe një listë e kandidateve të mundshëm: në rast se do të ndërmerrej një proces i ri lumnimi: në këtë rast, Atë Anton Harapi do të ishte në vendin e parë të një liste të dytë të mundshme të të



Atë GJON SHLLAKU O.F.M.



Atë ANTON HARAPI O.F.M.

lumëve.

Sigurisht që koha e procesit nuk do të jetë aq e shkurtër, si në rastin e 38 të Lumëve tanë, por kjo nuk përjashton faktin se mund të ndërmerret një tjetër nismë e tillë. Është e nevojshme vetëm që të kemi vullnet dhe gatishmëri për të bërë punën e madhe që kërkon një rrugëtim i këtij lloji: ata që kanë punuar bashkë me mua për të arritur te data 5 nëntor 2016 mund të dëshmojnë se sa kohë dhe energji është dashur për të filluar, për të vazhduar dhe për ta përmbyllur atë Çështje lumnimi.

Ndryshe nga Atë Harapi, i Lumi Gjon Shllaku nuk paraqiti probleme të veçanta në rrugën që çoi në Lumnimin e tij nga Kisha. Edhe pse ka bashkëpunuar me Atë Harapin në sferën politike, ai nuk u përfshi në të njëjtën mënyrë për sa i përket përgjegjësisë së drejtpërdrejtë, përveç kryesisë së përkohshme në partinë “Besa shqiptare”.

Por edhe kjo përfshirje e tij politike u drejtua dukshëm nga motive më të larta, duke e përqendruar të gjithë reflektimin e tij filozofik dhe sociologjik në binomin “fe dhe atdhe”, duke na bërë të kuptojmë se angazhimi i tij politik kishte natyrën teologjike.

Prandaj, te ai del në pah personaliteti i tij si njeri i shuguruar, me një drejtësi të madhe morale, të cilit diti t’i shtojë njohuritë dhe kulturën që kishte kultivuar gjatë viteve të studimit dhe të mësimdhënies. E gjithë kjo e kombinuar me dhuntitë e tij shpirtërore

të cilat u shfaqën, sidomos, në momentin e dënimit me vdekje dhe në ditët menjëherë para martirizimit të tij.

Po e përfundoj siç e fillova, duke cituar Siracidin: *“Në pasardhësit e tyre mbeti trashëgim i pasur, nipat e tyre, trashëgimtarët e tyre besnikë të Besëlidhjes, në saje të të parëve edhe bijtë e tyre”* (Sir 44,11-12).

Në këtë mënyrë uroj që të gjithë ne, e veçanërisht Familja e Fretëve Minorë, të jemi të denjë për Etër të tillë, duke vazhduar në angazhimin e fesë dhe të dashurisë për atdheun, për të qenë edhe ne sot të aftë të lëmë gjurmë për brezat e ardhshëm, me një shikim të aftë për të shkuar përtej të tashmes, gjithmonë në logjikën e fesë, të shpresës dhe të dashurisë.

Faleminderit!
+ Angelo Massafra



KRYIPESHK VIA SHKODËR-PULT

Prot. nr. 87/2021

Shkodër, më 16/10/2021

FAMULLIA E SHKODRA EMËRTOHET NË “ZOJA E SHKODRËS”

Objekti: Dekret për riemërtimin e Famullisë me seli në kishën Katedrale të Shkodrës

DEKRET

Çdo kishë e veçantë e ka qendrën e saj në Katedralen e Dioqezës, seli e Katedrales së Ipeshkvit, nga e cila ai ushtron mbarëshkrimin e tij si bari që drejton, mëson dhe shenjtëron popullin që i është besuar.

Kjo nuk përjashton që, bashkangjitur me kishën Katedrale, mund të ketë një pjesë të Popullit të Zotit që mund të identifikohet, territorialisht, në entin juridik “Famulli”.

Kështu është për Katedralen tonë të Shkodrës që mban emrin e Shën Shtjefnit protomartir, emër të cilin e mban njëkohësisht edhe Arqipeshkvia Shkodër-Pult.

Në vitin 1996, Famullia, e cila e ka selinë në Katedrale, ka marrë të njëjtin emër pa marrë parasysh as traditën as historinë.

PRANDAJ

1. Duke u bazuar në dokumentet historike dhe në vulat e të kaluarës të cilat tregojnë se e vetmja Famulli në Shkodër i kushtohej “Zojës së Këshillit të Mirë”;

2. Pasi u konstatua se Mons. Loro Nodaj, famullitar i Katedrales, nga maji 1993 deri në qershor 1995 i ka nënshkruar dokumentet e famullisë me vulën e Arqipeshkvisë;

3. Pasi u pa se Mons. Lucjan Avgustini, famullitar që nga 14 korriku 1995, fillimisht i ka nënshkruar dokumentet me vulën: “Kisha Katedrale - Famullia e Shkodrës” dhe vetëm me datën 9 prill 1996 ka lajmëruar zyrtarisht entet e ndryshme publike (si p.sh.: Postën, Bankën Tregtare, etj.), që duke filluar nga ajo datë famullia do t'i kushtohej “Shën Shtjefnit”;

4. Pasi u pa dhe u mor parasysh se si para komunizmit ashtu edhe fill pas rifitimit të lirisë fetare, domethënë që nga viti 1992, në qytetin e Shkodrës besimtarët kanë kremtuar dhe ende sot kremtojnë solemnisht “Festën e Zojës së Shkodrës”, të

hënën e tretë të muajit tetor. Kjo festë përjetohet si një “festë tradicionale” dhe “festë e pajtores”, me një pjesëmarrje të madhe të njerëzve që ndjekin procesionin me ikonën e Virgjërës Mari;

5. Pasi u konstatua se besimtarët dhe kleri nuk e kanë ndjerë kurrë si të tyren festën e Shën Shtjefnit si Pajtor të Famullisë, dëshmi për këtë është zhgënjimi i madh i shumë njerëzve në vitin 1996, dëshmuar edhe nga shprehja e Atë Gjergj Vatës S.I., njohës i mirë i jetës kishtarë të Shkodrës, i cili ka thënë: “Na ndjeftë Zoti! Na faltë Zoti!” Unë kurr nuk e kam ndie përpara këtë emër të famullisë së Shkodrës”

6. Duke marrë parasysh që Këshilli Presbiteral, në takimin e mbajtur me datën 17 qershor 2021, u shpreh njëzëri për kushtimin e famullisë “Zojës së Shkodrës”, në mënyrë që të dallohet nga Katedralja që mban emrin “Shën Shtjefni”;

I Mbështetur nga mendimi në favor i Këshillit Presbiteral, në respekt të plotë të traditës historike dhe të devocionit të besimtarëve të Arqipeshkvisë dhe të qytetit të Shkodrës në veçanti,

DEKRETOJMË

që Entit juridik “Famulli” me seli në Katedralen e Shkodrës t'i jepet emri “Zoja e Shkodrës”, ndërsa Entit juridik “Katedralja” t'i ruhet emri “Shën Shtjefni, Protomartir”.

Ky Dekret hyn në fuqi duke filluar nga data 18 tetor 2021, festa tradicionale e “Zojës së Shkodrës”.

Me shpresën se ky dekret do të mirëpritet nga të gjithë, e shoqëroj atë me bekimin tim.

Atë Artan Seli S.D.S.

Kancelar

† Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult



KTHIMI I LIN DELIJËS NË SHKODËR

Është kënaqësi e madhe të gjendemi sot në Shkodër e të flasim për artistin shkodran, Lin Delija, një artist që nderoi Shqipërinë dhe Italinë.

Megjithëse Shqipëria komuniste e shtrëngoi të lënte veladonin françeskan, Lin Delija, i strehuar në Romë e më vonë në Androdok, një fshat në provincën e Rietit, me fuqinë e brendshme të tij vazhdoi të punonte pa pushim për të dëshmuar identitetin shqiptar fetar dhe shpirtmadhësinë që i këshilloi të mos urrey as armiqtë në emër të mësimi të Krishtit.

Në Itali, si nxënës i Akademisë së Arteve të Bukura, në Via Ripetta në qendër të Romës, shfrytëzoi shumë mirë mësimet e Shkollës Romane të profesorit Mario Maffai dhe të gruas së tij Antonietta Rafaël, çka i lejoi të diplomohet me lavdi të gjithë komisionit akademik.

Por me gjithë mundësitë që i ofruan shumë miq, duke u nisur nga prof. Ernest Koliqi, për të punuar në Kryeqitet, Lin Delija preferoi të gjente strehë në një fshat, në Androdoko, në provincën e Rietit, ku në qetësinë e ambientit, dhe në frymëzimin e maleve që i kujtonin ata të Malësisë së Shkodrës, u realizua si piktor me zë në kuadrin e artistëve të shekullit XX.

E solli fati që Lini të takonte personalitete që e çmuan dhe e vlerësuan në gjithë aktivitetin e tij: mjafton të kujtojmë prej fillimit Imzot Luigj Sfefani i cili, sapo hapi në Firenзе “Akademinë e Lirë”, thirri Linin si profesor të kurseve të artit figurativ. Atje takoi përsëri mikun të liceut në Shkodër, Mark Lukoviçin, me origjinë nga Tivari, i cili së parri kishte dhënë mësim në Institutin e artit në Algero, dhe pastaj në “Akademinë e Lirë” të Firenзе-s. Në vitin '59 Lin ekspozoi 20 tablo në Gallerinë “Lo Sprone” në Firenзе bashkë me Mark Lukoviçin.

Shpesh herë midis artistëve lind njëfarë zilie, por në rastin e Lin-Lukoviçit lindi një shoqëri e sinqertë.

Më pëlqen të kujtoj gjykimin që Lukoviçi shprehu për Linin: “Ai (Lini), për aftësinë e tij, për pasurinë e ngjyrave në tablotë e tija, dallohet nga të gjithë të tjerët... Ai dëshironte të lartësonte, në veprat e tija, virtutet thelbësore të njeriut katolik... Ai vlerësohej nga artistët e tjerë për risinë që ai fuste në artin fetar... Ai në artin e tij përfaqësoi dhimbjen e popullit të tij, të shoqërisë, të familjes së tij dhe të tijin personal... ishte me të vërtetë origjinal”.

Në Androdoko Lini jetoi në mënyrë të veçantë për dy arsye: nga njera anë sepse nën aspektin vetjak, privat, kaloi një jetë të vetmuar, i tërhequr si një murg – mjaftonte t'i bëje vizitë për ta parë të strehuar në një apartament të vogël ku pushonte dhe pikturonte, por, mund të shtojmë, edhe ku lutej; nga ana tjetër Lini arriti të mbante njëkohësisht lidhje me botën e jashtme. Ai gjeti miq që e ndihmuan me zemërgjerësi në organizimin e ekspozitave të veprave të tij (në Androdoko, në Firenзе, në Romë, në Rieti, në Modena, në Pescara dhe në qytete të tjera), si edhe në hapjen, në Androdok, të shkollës për artin të kushtuar Gjergj Fishtës, ku ai mbante kurse për studentë artdashës, dhe në hapjen, më vonë, të “Akademiës së lirë të Arteve të Bukura” kushtuar



“Carlo Cesi-t”, piktor dhe skulptor nga Androdoko i shekullit XVII.

Kur pastaj me kohë fitoi nom si piktor i madh dhe si “njohës i thellë i artit fetar bashkohor”, u ftua në Amerikë nga shoqata pan-shqiptare “Vatra” ku ekspozoi 30 piktura së bashku me piktorin Ibrahim Kodra; dhe më vonë në Gjermani ku iu organizua një ekspozitë personale shumë e suksessme.

Miq të dashur, si Armando Nicoletti, familja Flaminio Brunelli, familja Roncaglia-Campanelli dhe Prof. Sante Graciotti, edhe pas vdekjes, e nderuan në mënyrë të merituar me organizimin e dy Muzeve: Muzeu në Androdoko, kushtuar “Lin Delisë dhe Carlo Cesi-t” dhe Muzeu i Qytetit të Osimos ku dega e kushtuar Lin Delijës mbledh veprat e dhuruara nga familja Roncaglia-Campanelli.

Kultura e pikturës së Linit

Kultura popullore shqiptare është në bazë të formimit të identitetit dhe të kulturës së Lin Delijës. Mjeshtërit e tij françeskanë e pajisën me mjetet e interpretimit të një realiteti kulturor që kishte rrënjët në qytetërimin illir. Mjafton të kujtojmë letërsinë popullore shqiptare në katër vëllime të “Visaret e kombit” (1937-1939), me bashkëpunimin e Bernard Palajt dhe Donat Kurtit, si edhe përmbledhjen e At Vinçenx Prenushit “Visari kombtar” (1911), dhe në përgjithësi kontributin kulturor të revistës “Hylli i Dritës”. Në ndeshjen me krishterimin, nënshtresa pagane, në fillim, i kishte bërë ballë k, por pastaj u shkri ture i lënë disa elemente të kulturës së saj. Emblematik legjislacioni popullor i kodifikuar në Kanunin e Malësisë të Lek Dukagjinit. Shumë figura që hasim në pikturat e Lin Delijës, mund t'i interpretojmë si bashkë egzistencë e elementit pagan me të krishterin që zgjidhet më gjerësisht në harmoni midis elementit njerëzor dhe hyjnor.

Një shembull e kemi në pikturën e Gjergj Kastriotit Skanderbeut, ku fatosi shqiptar përfaqësohet me figurën e Shën Gjergjit, ndërsa kafsha e shumëtrajtëshme na kujton kulshedrën, për të cilën ka shkruar At Gjergj Fishta në kapitullin XVI të “Lahutës së Malcis”. Me fjalë të tjera skenari bëhet më i gjerë, kur lufta midis fatosit Shënderbe dhe Turqëve interpretohet si luftë midis njeriut dhe fuqive të së keqes.

Drama që e sheh njeriun në luftë midis së mirës dhe së keqes, në veprën e Lin Delijës shfaqet si soditje e së bukurës që sqaron visionin njerëzor. Në fakt, elementi hyjnor, shumë i pranishëm në artin piktorik të Lin Delijës, nuk është vetëm kujtim dhe tejfytirim i përvojës jetësore, por njëjtësim me hyjnoren që është mishëruar historikisht në jetën e njeriut.

Në artin e shekullit XX, Lin Delija është një nga piktorët e pakët që parapëlqen hyjnoren, e e interpreton si nevojë të jetës, si lartësim të shpirtit ndaj Madhështoris, dhe si burim frymëzimi për rrugëtimin njerëzor.

Një nga kritikët e parë të veprës piktorike të Lin Delijës, kritiku dhe ikonografi bizantin arbëresh Pietro Tamburi nga Eparkia e Ugrës (Lungro), me ndjeshmëri të rrallë dhe me



shpirt estetik të hollë, në vitin 1960, në revistën “Shejzat”, pas konstatimit që në artin bashkohor mungon frymëzimi i artit fetar, - në kundërshtim me traditën e shekujvet të kaluar që kishin prodhuar kryevepra të pavdekëshme, - shkruan se Lin Delija, “në ndjesinë e tij fetare gjen frymëzimin e artit të tij”. Me të vërtetë, Lin “ngre nga toka ku lindi një ndjenjë mistike të fesë së jetuar, të panjohur në perëndim”.

Gjykimi i Pietro Tamburi-t gjen përkim me gjykimin e kritikut të njohur italian Vittorio Sgarbi, i cili, konstaton se vepra e Lin Delijës është vërtet origjinale, sepse Lin Delija, kundër humanizmit pa Hynë të shekullit XX, jo vetëm zhytet në përvojën humane, si piktor të tjerët, - p. sh. Paul Cézannë, Henri Matisse, Claude Monet – por i drejtohet Hyjnisë si plotësim eksistencial, si harmoni midis njerëzores dhe hyjnore.

Lin Delija kthehet në Shkodër

Pas shembjes së regjimit komunist, në vitin 1992 Lin Delija kthehet për herën e parë në Shqipëri, për arsye personale (martesa e një nipi); ndërsa në vitin pasues disa piktura të tij kthehen me ekspozitën që Ambasada e Shqipërisë në Romë organizoi, me tablo të Lin Delijës dhe të Diana Belotti de Cataldo, që u mbajt më parë në Romë, dhe pastaj në Tiranë dhe në Shkodër.

Janë, këto, dy shenja që dëshmojnë për kthimin e Lin Delijës në dheun e tij.

Tani, sivjet, me aktdhurimin e 25 piktura që trashëgimtarët e Imzot Eleuter Frangjisk Fortino-s i kanë bërë Imzotit Engjëll Masafres për Pinakotekën Dioqezane të Shkodrës, na duket se Lin Delija kthehet një herë tjetër në dheun e tij.

Lin Delija këto 25 piktura ia kishte dhuruar Imzot Eleuterit, si dhuratë personale dhe si mirënjohje për ndihmën që Imzot Eleuteri i kish siguruar në raste të ndryshme.

Në fakt, Imzot Eleuteri, më parë se të vdiste, ka shprehur dëshirën që këto tablo të ktheheshin në Shqipëri. Kjo dëshirë po realizohet praktikisht sot me inaugurimin e Pinakotekës Dioqezane “Lin Delija”.

Cili është mesazhi që mund të kapet nga këto 25 tablo të Lin Delijës?

Siç mund vërehet edhe nga një shikim i shpejtë të këtyre pikturave, del qartë se janë piktura që shprehin dhimbje të thella: së pari dhimbjen personale që provon njeriu që jeton në mërgim, së dyti dhimbjen kolektive të popullit shqiptar, sidomos të atyre që pësuan përndjekje, tortura, dhe në shumë raste vdekje. Linin e preku thellë në zemër vdekja e Imzot Vinçenc Prenushit, Kryetar i Françeskanëve në Shqipëri dhe pikëreferim i gjithë katolikëve shqiptarë.

Kjo pikturë e Lin Delijës është një rënkim i bërë me mjete artistike të ralla që transmeton dhimbje të thella dhe tragjike.

Simboli dhimbjeje të shkallës më të lartë është fytyra e Krishtit të vënë në kryq të përfaqësuar në shprehje të ndryshme.

Pas fytyrave të Krishtit, një pjesë e konsiderueshme e këtyre pikturave përfaqëson martirizimin e Françeskanëve nga ana e regjimit komunist. Këto piktura përfaqësojnë një histori shumë të dimbshme, duke u nisur nga imazhet e pushkatimit, deri në shprehjet e dhimbjes së brendshme të Françeskanëve që shkojnë për në pushkatim, me vetëpërmbytje dhe me qetësi shpirtërore shembullore.

Një tragjedi që do të kërkonte shpagim, por që nga sjellja e të pushkatuarëve del qartë mësimi evangjelic:

“Fali atyre pse nuk dinë atë që bëjnë”.

E dëshmojnë 38 martirët që Papë Frangjisku ka shpallur të lumtur në Shën Pjetër më 2016.

Një shembull i fesë së fortë për gjithë besimtarët dhe për dyshuesit.

Imzot Eleuter Frangjisk Fortino

Por kush është Imzot Eleuter Frangjisk Fortino;

Ai është dhuruesi i këtyre 25 pikturave që do të nderojnë Pinakotekën Dioqezane të Shkodrës me nismëtarin e saj Imzot Engjëll Massafran, por të nderojnë kryesisht artistin e madh Lin Delijen, që në këtë mënyrë rikthehet në vendlindje ku vazhdon të jetojë duke treguar me historinë e tij qëndrueshmërinë e njeriut për fitoren e plotë të së vërtetës.

Imzot Fortino është një arbëresh nga Eparkia e Ungrës, Eparkia arbëreshe që mbledh shumicën e fshatrave arbëreshë të Italisë gadishullore.

Por Imzot Eleuteri nuk punoi në Eparki, sepse pas shugurimit prift më 24 nëntor 1963, u thirr nga Kardinal Bea për të punuar në sektorin lindor të Sekretariatit për Bashkimin e të Krishterëve në Vatikan, ku punoi deri në datën e vdekjes më 22 shtator 2010. Po në të njëjtin vit iu besua rektorati i Kishës katoliko-bizantine të Shën Thanasit në Romë, ku shkojnë rregullisht arbëreshët që banojnë në Romë, afro 5000 banorë.

Në Sekretariatit për Bashkimin e të Krishterëve e ngarkuan së shpejti me funksione ndërkombëtare: së pari që kryetar i delegacionit katolik, duke u bërë protagonist i shquar i dialogut ndërfetar, për të redaktuar, me pëlqymin e të tre delegacioneve, katolikë, ortodoksë dhe protestantë, lutjet që çdo vit thuhet me rastin e Javës së Lutjeve për Bashkimin e të Krishterëve, java 17-25 janar. Marrëdhëniet e mira dhe të frytshme që arriti të krijonte në fushën e bashkëpunimit midis katolikëve, ortodoksëve dhe protestantëve, i vlenë emërimin “Nënsekretar” në Këshillin Papnor për Promovimin e Bashkimit të Krishterëve, detyrë që vazhdoi me shumë suksese deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Njëkohësisht Imzot Stamati, Peshkop i Eparkisë së Ungrës, i dha titullin “Arkimandrit” për meritat në fushën e Bashkimit të Krishterëve; dhe për të njëjtat merita Papa Pavli VI e emëroi “Kapelan të Atit të Shenjtë”, me titullin “Monsignore” (Imzot), dhe pastaj Papa Gjon Pali II e emëroi “Prelat dhe protonoter apostolik”.

Prej vitit 1980 mbajti edhe detyrën Sekretar, për anën katolike, të Komisionit të Përzier Ndërkombëtar të Dialogut Teologjik Katolik-Ortodoks.

Nderimi, ndoshta më i rëndësishëm, që iu dha, është Trandafili i Argjenditë i Shën Kollës në vitin 2008 nga ana e Institutit Ekumenik të Universitetit të Friburgut në Zvicër si edhe të Institutit të Kishave Lindore të Regensburgut në Gjermani për zellin e tij në fushën e ekumenizmit.

Vitin 2009 Komuna e Shën Mitrit, fshat arbëresh në provincën e Kosencës, i dha çmimin “Arbëria” për interesin e tij të madh për traditën kishare bizantine të arbëreshëve të Italisë dhe për kulturën e tyre të veçantë.

Në fund me kënaqësi falënderoj, në emër tim personal, dhe patjetër në emër të vëllait tim Eleuter Frangjisku, që nga qielli na bekon, Imzot Engjëll Massafran për këtë nismë kaq të çmuar që e lartëson emrin e birit të madh të Shkodrës.

Redaksia



30-VJETORI I RIHAPJES SË MISIONIT TË MOTRAVE STIGMATINE NË SHQIPËRI

“Vërtetë Zoti bëri për ne mrekulli e zemrat na u mbushën më gëzim” (ps 125,3).



Instituti i “Bijave të Varfëra të Varrëve të Shenjta të Shën Françeskut”, i themeluar nga e nderuara Motër Anna F. Lapini, pati fillimin zyrtar nga viti 1850, në Firençe, Itali, të cilat populli i Firences i thërriste: “Motra Stigmatine”. Motër Anna Lapini e shtyrë nga dashuria e Krishtit Zot-Njeri i Kryqëzuar, dhe nga pasioni për të varfrit, i kushtohet veprave të ndryshme të bamirësisë, me dëshirën që të kujdeset për “varrët” e njerëzve të kohës. Siç thotë edhe Ungjilli: Samaritani u “kujdes” e tha “kujdesu” (Lk,10).

Qëllimi. Motrat tu dedikohen mbi të gjitha mësimi fetaro-kulturor të vajzave më të varfra e të braktisura, të zbatojnë me përpikmëri Varfërin e shenjt; t’i duan dhe t’u shërbejnë të varfërve me dashuri e nderim, për lavdinë e Zotit dhe të mirën e shpirtit.

Mbi këto vlera Instituti i ynë pati një lulëzim të frytshëm në mbarë vendin, si dhe në Shqipëri që nga viti 1879-1946. Pas 67 vite lulëzim, Natën e Krishtlindjes të vitit 1946, komunizmi u mundua ta presë këtë pemë në trunqun e saj, duke mbyllur Kuvendin e Motrave në Shkodër dhe në vijim të

gjitha bashkësitë e tjera në Shqipëri: *Korçë, Durrës, Tiranë, Shirokë, Dajç B. Bunës, Nënshat, Rus (lagje Shkodër).*

Porse, veprën e Zotit askush nuk mund ta pengojë dhe rrënjët e besimit në Të, asnjë fortunë nuk mund ti shkulë. Pesëdhjetë vite në vuajtje e qëndresë, rilindi shpresa edhe më e fortë me dëshirën për të ndjekur Krishtin deri në fund. Edhe pse komunikimi ishte i vështirë, Motrat shqiptare gjithmonë kanë qëndruar në marrëdhënie me Motrat Eprore të Kongregatës sonë. Të nxitura nga shpirti i bashkimit me njëra-tjetrën, Eprorja e Përgjithshme Motër Giovanna Pedali erdhi në Shqipëri në vitin 1991, për të takuar motrat që ishin të pranishme pas komunizmit. Gëzimi dhe përmallimi i pakufi karakterizojnë takimin e Motrave nga çdo fshat e qytet për të përjetuar një takim vëllazëror të lirisë fetare. Kuvendi munda t’i hapë dyert e veta, sepse ende ka limfë, që del prej trunqut të vjetër dhe rrënjët, të ushqyera mirë me gjakun e martirëve, japin jetë të re.

Me kontributin e motrave misionare të ardhura në Shqipëri (Madre Paola Paqualini, Sr Chiara Pieri,



Sr Elena D'Avanti, Sr Candida Paladino, Sr Luisa Lopez, Sr Caterina Vurro), si dhe motrat tjera që shërbyen në periudha të ndryshme, dalëngadalë u rigjallërua jeta e Kuvendit me thirrje të reja rregulltare. Në vitin 1991 u rihap Kisha, nga Atë Aleksandër Baqli O.F.M. dhe po në këtë vit, me 17 shtator, pas 47 vite, pritje e qëndresë, bënë Kushtet e para rregulltare Motrat e post-regjimit komunist: *Liljana Radovani, Lorencina Leci, Pina Shestani, Gjystina Doda, Gjorgjina Bulgareci, Margerita Cepi, Adelajde Pashkja, Marija Kaleta, Roza Kraja*, celebri, Atë Konrad Gjollaj O.F.M. Njëkohësisht, vijuan rihapjet: *Shirokë, Dajç, Pistull, Nënshat, Hajmel*.

Instituti, gjithmonë është kujdesur për formimin shpirtëror-karizmatik, njerëzor-kulturor të të gjitha Motrave. Motrat në moshe janë si Mosiu në mal që me lutje dhe ofertën e vuajtjes së tyre, ndihmojnë ecjen e ripërtëritjes së Kishës lokale.

Në vitin 1997, Eprorja e Përgjithshme Motër Giovana Pedali, emëron Madre Paula Pasqualini-n delegate në Shqipëri, pasi ia kushtoi Delegacionin shqiptarë “Zojës së Këshillit të Mirë”, Pajtores e Shqipërisë.

Motrat Stigmatine gjithmonë kanë kërkuar t'u përgjigjen shenjave të kohës, duke ruajtur frymën e vëllazërisë dhe të thjeshtësisë françeskanë.

Në pamundësi për t'i rifilluar aktivitetet e mëparshme, misioni i Stigmatineve tani e tutje do të ishte: “*Të jetojmë në mes njerëzve dhe për njerëzit*”, për t'i përforcuar ata në fenë katolike dhe në vlerat njerëzore, me anë të pjesëmarrjes në baritoren famullitare.

Kryesore: Soditje ndaj Krishtit të Kryqëzuar duke i shërbyer në të kryqëzuarit e kohës.

Mikpritje për të gjithë dhe gjithmonë, duke u mbështetur në Provanin hyjnore dhe në punën e përditshme.

Motrat Stigmatine, janë të pranishme në dioqezën e Shkodrës dhe të Sapës. Jetojmë të hapura ndaj Karizmës stigmatine-françeskane sipas nevojave të Kishës.

Në kujtim të 30-vjetorit të misionit pas regjimit komunist, 1991-2021, pas një shqyrtimi të kujdesshëm

mbi realitetin që vendi ynë po jeton, Motrat Stigmatine hartuan një projekt: “Si një familje” për të moshuarit, i cili u realizua me 23 tetor 2021 me emërtimin: Resideca për të moshuar, “Anna Fiorelli Lapini”, vepër kjo e Provanisë hyjnore, në Shirokë. Ceremonia e përzimit u hap me një fragment muzikor nga prof Lorenc Radovani dhe Gjon Shllaku, mt Dukata Radoja prezantoi motivacionin e kësaj vepre e cila, *në parim, ka në qëndër personin njerëzor dhe plotësimin e nevojave të tij*. Ritin e bekimit e udhëhoqi Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi i dioqezës Shkodër-Pult si dhe Nunci Apostolik në Shqipëri Sh. e Tij Imzot Luigi Bonazzi, i cili në fjalimin e tij theksoi: “Zakonisht ai që ka festë merr dhuratë.

Përkundrazi janë motrat stigmatine ato që po bëjnë një dhuratë të çmuar kësaj toke: Residencën për të moshuar “Anna Fiorelli Lapini” dhe Ambulancën e riaftësisimit “Don Natale Montevani, misionar, i cili punoi për disa vite në Shqipëri, pikërisht në Shirokë”. Me pas vijoi festimi me një koreografi: “Të duash, të mbretërosh”, nga kori i famullisë Nënshat-Hajmel. E pranishme ishte edhe Eprorja e Përgjithshme Motër Encarna Lobato e cila në përshendjetjen e saj pohoi: “Kjo vepër lind si mikpritje dhe shërbim ndaj të moshuarve, të cilësuar si të vetmuar dhe të kryqëzuarit e kohës sonë”. Ky aveniment, u mbyll me interpretimin e këngës: “Grande è il tuo genio di donna per noi”, të kënduar nga Rigersa Loka, dhe me një koktel vëllazërore, shenjë gëzimi e falenderimi Hyjit dhe bamirësve.

Me datë 24 tetor 2021 në kujtim të së Lumës Martire Marie Tuci, u kremtua Mesha e Shenjte e udhëhequr nga Imzot Angelo Massafra O.F.M., Arqipeshkvi i dioqezës Shkodër-Pult. Bashkëcelebruan Kustodi i fretërve minor Fra Pashk Gojçaj, Rektori i seminarit Dom Leonardo Falco, delegati i fretërve minor Kapuçin Fra Bonaventura Massuto si dhe meshtarë të tjerë. Në fillim të Meshës mt Terezina delegate e Motrave Stigmatine në Shqipëri, paraqiti historikun e shkurtër të 30-vjetorit të misionit pas regjimit. Imzot Angelo në omelin e tij, kujtoi: “Kisha ka nevojë për meshtarë, të bashkëpunojmë të gjithë për thirrje, kemi bashkë-përgjigjësi që të propozojmë, jo të imponojmë, të mos i pengojmë të rinjtë kinse për një jetë më të mirë ekonomike. Marie Tuci ka pasur një rol edukativ në kohë të vështirë, duke jetuar vlerat e solidaritetit me ata që vuanin më të në burg”. Në mbarim të Meshës Eprorja e Përgjithshme Motër Encarna Lobato, falenderoi të pranishmit, Motrat që kanë jetuar në besnikëri ndaj Zotit, në vuajtje, në heshtje të forcuara nga ajo kohë e errët. Falenderoi të gjithë ata që kanë ndihmuar dhe bashkëpunuar me Motrat gjatë këtyre 30 viteve, pastaj ju dhuroi bekimin e Papës Françeskut, mt Marie Kaletes e mt Roza Krajes në kujtim të 30 vjetorit të Kushteve rregulltare. Ky festim u mbyll me një ekspozitë të jetës së Motrave në Shqipëri.

Motrat Stigmatine



Imzot Angelo Massafra – Arqipeshkëv
Shkodër, 21.10.2021

TA KËRKOJMË NDIHMËN E SHPIRTIT SHENJT! *Hapja e vitit Akademik*

Shumë të dashur,
hapja e vitit akademik në Universitet na bën që të gjendemi sërish të mbledhur rreth altarit për ta dëgjuar zërin e Jezusit Mësues dhe për t'u ushqyer me praninë e Tij të gjallë në Bukën Eukaristike.

Është një mundësi e privilegjuar për ju që të takoheni, të rinj besnikë të Krishtit, në Kishën që ju lindi si bij të Hyjit; ajo Kishë e cila, pikërisht sepse ju ndien si bij, dëshiron ta dëgjojë zërin tuaj dhe të pasurohet me kontributin tuaj të mendimit dhe të veprimit përmes Sinodit që e kemi shpallur të hapur të Dielën e kaluar dhe që së shpejti do t'ju kërkojë të plotësoni një pyetësor të përgatitur posaçërisht për këtë rast. Në fillim të këtyre konsideratave të mia që po bashkëndaj me ju, dëshiroj t'ju nxis që të mos tërhiqeni kur t'ju pyesin: Kisha ka nevojë për ju dhe për energjitë tuaja të reja, që ta vazhdojë misionin e saj për kumtimin e Ungjillit.

Në fakt, jemi në muajin kushtuar Misionit dhe afër Ditës Botërore të Misionit; kështu, kemi rast të marrim pjesë në misionin e Birit të Hyjit për t'ia kumtuar lajmin e mirë të Ungjillit burrave dhe grave të kohës sonë.

Është Fjala e Hyjit që sapo kemi dëgjuar e cila na ofron koordinatat brenda të cilave të lëvizim në veprimin tonë misionar: e njëjta që ka karakterizuar misionin e Jezusit. Në radhë të parë, qëllimi i misionit: të hedhim zjarr në tokë. Kujdes! Nuk bëhet fjalë për zjarrin e gjykimit të fundit, por për zjarrin e Shpirtit Shenjt në të cilin jemi pagëzuar. Zgjedhja për të qenë të Krishtit është një formë gjykimi që na bën të shohisim atë që është e mirë nga ajo që është e keqe dhe na shtyn të bëjmë vullnesën e Hyjit në jetën tonë.

Edhe Shën Pali në Leximin e parë na foli për një zgjedhje: atë midis të mirës që çon në jetën e përjetshme dhe të keqes që, përkundrazi, na çon në vdekjen e përjetshme. Dhe ju e dini shumë mirë se papastërtia për të cilën na foli Shën Pali është shumë e pranishme në shoqërinë tonë, ku edhe e mira kalon si e keqe dhe e keqja si e mirë. Prandaj, kemi shumë nevojë që të kërkojmë ndihmën e Shpirtit Shenjt që kemi marrë në pagëzim, krezmim dhe që gjithmonë marrim në sakramentet që kremtojmë, me qëllim që të dimë të shohisim, të gjykojmë dhe të veprojmë në përputhje me rrethanat.

Së dyti, "ankthi" i Jezusit në pritje të realizimit të kësaj derdhjeje të Shpirtit Shenjt. Është i njëjti ankth që duhet të karakterizojë çdo të krishterë: dëshira që krejt bota të shpëtohet dhe të shenjtërohet nga prania e Shpirtit. Nëse edhe ne e lëmë veten të na pushtojë ky ankth pozitiv, atëherë do të jemi kumtues të vlefshëm të Ungjillit dhe misionarë në vendin ku secili prej nesh

jeton dhe punon. Pa dyshim, vendi juaj i privilegjuar duhet të jetë universiteti ku mund të jeni apostuj të vërtetë të Krishtit.

Së treti, ndarja. Po... për fat të keq, të qenit të Krishtit nuk na gjen gjithmonë gati dhe bujarë. Gjithmonë duhet të heqim dorë nga diçka, madje edhe me dhimbje, në mënyrë që t'i përkasim plotësisht Atij dhe ta dëshmojmë Atë me vepra të mira. Ashtu si do të gjendemi në situata largimi me ata që nuk duan ta pranojnë shembullin tonë të jetës dhe t'i pranojnë fjalët tona të mira si dëshmitarë të Krishtit. Por krahas kësaj vuajtjeje ekziston edhe ngushëllimi i lumturisë së premtuar nga Jezusi: "*Të lumët ju kur t'ju shajnë e t'ju salvajnë dhe kur, për shkakun tim, t'i thonë të gjitha të zezat kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni, sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell!*" (Mt 5, 11-12).

Papa Françesku ju nxit edhe që të shfrytëzoni një tjetër mjet për të qenë protagonistë të botës tuaj dhe për të ndikuar pozitivisht në të ardhmen e planetit: atë të Paktit Edukativ Global, një edukim më i hapur dhe gjithëpërfshirës, i aftë për një dëgjim të bërë me durim, për një dialog konstruktiv dhe për një mirëkuptim të ndërsjellë. Në fushën e universitetit ju, studentë të krishterë, keni mundësi që të kërkonit të zbatohet ky pakt arsimor ku, së bashku me brezat që ju kanë paraprirë dhe që tani janë docentët tuaj, mund të arsyetoni së bashku dhe të diskutoni se si ta përmirësojmë shoqërinë tonë. Por kjo kërkon edhe një angazhim serioz në formimin kulturor, në përgatitjen akademike, në krijimtarinë e ideve të reja dhe në mundësitë e zhvillimit.

E vini re se sa njerëz janë duke u larguar nga Shqipëria; ndoshta edhe shumë prej jush kanë dëshirë të largohen. Por realiteti mund të ndryshohet me angazhimin e gjithsecilit dhe jo me largimin nga këtu! Pa ia lënë menaxhimin e jetës suaj atyre që janë në pushtet, por duke ofruar kontributin tuaj konkret në ndryshimin e mundshëm. Edhe kjo është pjesë e misionit të të krishterit: ta bëni botën në të cilën jetoni një vend më të mirë. Dhe mënyra për ta bërë atë është ajo që Jezusi sapo na tha me shembullin dhe Fjalën e Tij.

Nesër do të kremtojmë përkujtimin liturgjik të Shën Gjoni Palit II, Papës së të rinjë dhe që kishte kaq shumë shpresë tek të rinjtë. T'i lutemi që të marrim nga Jezusi zjarrin e Tij: Shpirti Shenjt na i nderon zemrat tona dhe na bëftë, çdo ditë e më shumë, misionarë të tij në këtë botë që aq shumë ka nevojë për Ungjillin e Tij të paqes, të shpresës dhe të gëzimit.

Urimet më të mira për këtë vit të ri akademik.

PËRURORHET BUSTI I MONS. ZEF OROSHIT NË LEZHË! KLERIKU THEMELUES I KISHËS 'ZOJA E SHKODRËS' NË SHBA

Lezhë, 13 dhjetor 2021.

Lezha e Kuvendeve ka vlerësuar në 109 vjetorin e lindjes klerikun, intelektualin dhe atdhetarin e shquar, themeluesin e kishës së parë shqiptare në Amerikë, sot "Zoja e Shkodrës" në Nju Jork, Monsinjon Zef Oroshi. Në ceremoninë e vendosjes së bustit pikërisht në sheshin Papa Gjon Pali II, morën pjesë autoritete vendore, përfaqësues të klerit katolik si edhe studiues, intelektualë nga Lezha, Mirdita, Kurbini, Shkodra etj.

Kryetari i Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu theksoi se "është një ditë e mirë, sepse jemi këtu për të përfunduar bustin e një burri shumë të madh, që ka vlera intelektuale, veprimtare dhe patriotike, jo vetëm për Lezhën, Mirditën dhe Shkodrën por për të gjitha trevat".

Përfaqësuesi i Dioqezës së Lezhës, Dom Angjelin Krygja theksoi se "ne qëndrojmë mbi shpatullat e heronjve, që kanë dhënë më të mirën e tyre për ne, një prej këtyre heronjve është edhe Monsinjon Zef Oroshi, themelues i kishës "Zoja e Shkodrës" në SHBA.

Një ndër iniciatorët e vendosjes së bustit është studiuesi Dom Nikë Ukgjini, i cili duke u ndalur në jetën dhe veprën e Monsinjon Zef Oroshit e vlerësoi si një figurë përbashkuese gjatë veprimtarisë së tij, jo vetëm në Evropë por edhe në SHBA.

Fjalën e rastit e mbajtën edhe studiuesja, Leonora Laçi e poetit Viktor Gjokola. Në këtë takim, u lexuan letrat përshëndetëse: Nunci Apostolik në Shqipëri, Imzot Luigi Bonazzi; ish drejtor Zërit të Amerikës, Fran Shkreli; Shoqata "Trojet e Arbrit" dhe shoqata "Vatra". Në të event u tha se duhet falënderuar, biografën dhe studiuesin, e Oroshit, atdhetarin, Tomë Mirjaj nga New Yorku; skulptorin e bustit Sadik Spahia, dhe ata që e mundësuan gjithë këtë vepër: Dy djemtë e vëllezërve të Mons. Oroshit: Gjon e Nikollë Prendi me djemtë e nipat të tyre.






Rita Ndoci
**DHJETË FJALËT
E JETËS**
Gjergj Fishta, Shkodër 2021



MICHEL REMERY
ONLINE ME SHENJTËRIT
*Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër - Pult, 2021*



FRANO KULLI
**FJALOR I VEPRËS SË
FISHTËS**
Botimet Fishta - Lezhë 2021

KUMBONA E SË DIELLËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 100 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në eleven studio - www.11stud.io